

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7319 E mërkurë 11 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
A koma nuk po zbehët jehona e një videoje të publikuar ditë më parë, ku në Elbasan dukeshin policë e shefa policie, të veshur e armatosur më së miri, që ...
Vijon në faqen 20

Nga FERDINAND XHAFERRI
Ambasadorët duhet të flasin edhe për Ramën dhe Bashën


Opinion **Ditës**
Celja e negociatave të anëtarësimit me BE-në ka dalë sërish dhe me të drejtë në plan të parë, dhe kjo është pozitive. Me këtë rast, krahas vlerësimeve objektive ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE
Fajin vetes, jo BE-së!



INTERVISTA
Aida Hudhri: Si mund të fitoni bursë
Këshilltarja e ambasadës: Hapat që ndiqen për të studiuar në SHBA

“Numri i aplikantëve në rritje, tarifat përcaktohen nga universitetet”
Nga VOLTIZA DURO
Shtetet e Bashkuara kanë hapur aplikimet për të gjithë ata që duan të vazhdojnë studimet në një prej universiteteve amerikane. Në një njoftim të publikuar në faqen e saj zyrtare, Ambasada ...
Në faqen 11

MINISTRI I FINANCAVE: SHEMBUJT KONKRETE, TATIMI NE BAZE TE ÇMIMIT TE REFERENCES

JA FORMULA E RE PER TAKSIMIN E SHTEPIVE

Harta e vlerës së tregut në të gjitha zonat e Tiranës dhe në çdo rreth të vendit. Pagesat për banesën do të nisnin nga 1 janari i vitit 2018

| Nr. | Qyteti | Indeksi bazë sipërfytyrës (shprehje) |
|-----------------------------|-------------|--------------------------------------|
| 1. Qyteti i Tiranës | | |
| 1 | Elbasan | 89,125 |
| 2 | Vlorë | 53,500 |
| 3 | Korçë | 53,500 |
| 4 | Durrës | 56,384 |
| 5 | Shkup | 41,000 |
| 2. Qyteti i Durrësit | | |
| 6 | Durrës | 48,540 |
| 7 | Elbasan | 48,500 |
| 8 | Shkup | 41,000 |
| 9 | Skopje | 41,000 |
| 10 | Prishtinë | 53,000 |
| 3. Qyteti i Shkupit | | |
| 11 | Shkup | 48,000 |
| 12 | Prishtinë | 53,000 |
| 13 | Vatë Durrës | 24,300 |
| 14 | Korçë | 48,500 |
| 15 | Prishtinë | 53,000 |
| 4. Qyteti i Vlorës | | |
| 16 | Vlorë | 50,800 |
| 17 | Shkup | 60,000 |
| 18 | Shkup | 25,000 |
| 19 | Prishtinë | 56,000 |
| 20 | Elbasan | 53,500 |
| 21 | Prishtinë | 56,000 |
| 22 | Prishtinë | 28,000 |
| 5. Qyteti i Korçës | | |
| 23 | Korçë | 44,412 |
| 24 | Prishtinë | 49,796 |
| 25 | Prishtinë | 36,000 |
| 26 | Elbasan | 56,000 |
| 27 | Mat | 27,800 |
| 28 | Lushnjë | 21,000 |
| 6. Qyteti i Fierit | | |
| 29 | Fier | 53,000 |
| 30 | Lushnjë | 40,100 |



(Në foto) Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

VRASJA E DEPUTETEVE
Hapja e dosjeve, Rama: Krenar që morëm nismën. Basha: I turpëruar
Në faqet 2-3

FLET AVOKATI
Ushtrarakët në ankth, s'behët i ditur vendimi për të kthyer paratë
Në faqen 12

INTERVISTA
U ndje i kërcënuar nga ish-prokurorja, Ledian Halilaj: Ja çfarë ndodhi
Në faqen 10

LISTA E PERDITUESAR
Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës
Në faqen 19

KUSH KRYESON


Pasuria e ministereve dhe deputeteve, nga apartamentet te llogaritë bankare
Në faqet 6-7

VIP Pages “Marrëdhënia e prezantueses me djalin tim dhe dëshirat e mia”

Flet vjehrra e Floriana Garos: Si ndjehem me të

Kryetarja e AK, Lumturi Ratkoceri: Si është rrugëtimi im në politikë

Nga ENIDA HIMAJ
Kryetarja e Aleancës Kërkuesi u shndërrua në kryefjalën e mediave, teksa u zbulua se ishte vjehrra e moderatores Floriana Garo. Lumturi Ratkoceri, vjen në një rrefim për suplementin “Vip Pages” të “Gazeta Sh-



qiptare” për të na zbuluar detaje nga rrugëtimi i saj në politikë dhe hapat që e çuan në krye të Aleancës Kërkuesi, gjithashtu për të treguar se sa ka ndikuar angazhimi politik në largimin nga familja dhe për marrëdhënien që ka me nusen e djalit. ...
Suplement

EKZEKUTIMI DEPUTETET

Dosja, nga thyerja e kockave te djegia e mishit, torturat ndaj deputetëve të arrestuar

Valentina Madani

Autoriteti për Hajpen e Dosjeve ka arritur të zbarchë materialet arkivore, ndonëse të palexueshme, të cilat ekzistojnë për gjyqin e zhvilluar ndaj 21 deputetëve të dënuar, 15 prej të cilëve u pushkatuan pasi iu kundërvunë kufizimit të lirive, duke u akuzuar si pro-perëndimorë. "Gazeta Shqiptare" zbarch dosjen hetimore të gjyqit të deputetëve, si dhe torturat çnjerëzore mbi trupin e tyre para se të pushkatoheshin te Mali me Gropa. Mes tyre ishin emra si Riza Dani, deputet i Shkodrës; Shefqet Beja, deputet i Durrësit; Enver Sazani, deputet i Durrësit; Selaudin Toto, deputet i Gjirokastrës; Irfan Majuni, deputet i Dibrës; Faik Shehu, deputet i Dibrës; Kosta Boshnjaku, deputet i Tiranës dhe Gjergj Kokoshi, deputet i Shkodrës etj. Grupi i deputetëve u morën si të pandehur nga regjimi komunist dhe u vunë në bankën e të akuzuarve në fillimin e shtatorit të vitit 1947. Në atë gjyq, i cili u zhvillua në kinemanë "17 Nëntori" të kryeqytetit nga data katër shtator e vitit 1947 e deri në datën 27 shtator, kur u dha edhe pretenca, u gjykuar si të pandehur 24 persona. Ky grup kishte marrë iniciativën për të penguar miratimin e projekt-kushtetutës së parë komuniste. Iniciativa e tyre për të ndaluar revanshin komunist do t'u kushtonte jetën jo vetëm deputetëve që kishin mundur të hynin në parlament, por edhe shumë bashkëpunëtorëve, duke arritur numrin e 40 vetave. Por, ata u arrestuan. Gjyqi u zhvillua në kinema "17 Nëntori" (National) në Tiranë, me po atë dekor të brendshëm dhe të jashtëm, me po ato parulla të hedhura nga turma e irrituar, sikurse edhe në Gjyqin Special të zhvilluar në kinema "Kosova". Shefqet Beja pati guximin të zhvishet në sallën e gjyqit, për t'i treguar trupit gjykses dhe të pranishmëve në sallë plagët e shkaktuara nga hekuri i skuqer në gjoks dhe në shpinë. Një pjesë e mirë e të pandehurve, nën efektin e torturave, pranuan se kishin krijuar një "Grup opozitar", për të vendosur në Shqipëri një regjim kapitalist. Pas shumë akuzash dhe kundërxorazhesh, Gjykata e Lartë nxori vendimin nr. 187, datë 27. 9. 1947: "... Për veprën e tradhtisë së lartë për rrëzimin e shtetit demokratik

Gjyqi, deputeti zhvishet në sallë, tregon torturat me hekurin e skuqur

Kërkesa për falje dhe ekzekutimi te Mali me Gropa



Faksimile e dosjes hetimore të deputetëve

Tabaku: 10 vjeçe dëgjiova historinë e Shefqet Bejes

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, në fjalën e saj në Kuvend tekta përkujtohej vrasja 70 vjet më parë nga regjimi i Enver Hoxhës i grupit të deputetëve opozitarë, tha se historia jonë është e trishtë. "Kam qenë 10 vjeçe kur dëgjiova për herë të parë hallën time të pëshpëriste historinë e Shefqet Bejes, në praninë time dhe të familjarëve të mi. Ende sot kujtoj fjalët e saj se si gjeti përpara pragu të shtëpisë, trupin e të ndjerit Beja, se si ushtarët e regjimit komunist dhe xhandarët e tyre e kishin larguar me vështirime nga trupi. I cili kish mbetur i varur aty në rrugicë për t'i treguar gjithkujt fundin e atyre që kishin ndarë mendjen të kundërshtonin partinë-shtet", tha Tabaku.



Gjyqi i deputetëve opozitarë të ekzekutuar nga diktatura komuniste

Gjyqi i opozitarëve, sajesa e Sigurimit të Shtetit

Kastriot Dervishi: Deputetët që vdiqën gjatë hetuesisë



shkruan ish-drejtori i Arkivit, Kastriot Dervishi. Sipas tij: "Nuk ka pasur kurrë 'grup deputetësh', por proces të parë. Është sajese e Sigurimit ky format, sepse procesi që përfundoi më 27 shtator 1947 është rastësor për sa i takon bashkimit të personave që u

Pseudonimi

deputetë të Frontit. Në gjyq Shefqet Beja, ndër të tjera deklaroi: "...thamë që t'i kundërshtonim (reformatsionim) në parlament, por nuk vendosëm, kështu, këto pikëpamje tona nuk i kemi parashtruar në Kuvend asnjëherë, pasi nuk e gjenim të nevojshme dhe nuk i konkretizim në mes tonë, me qenë se pikëpamjet tona nuk pajtoheshin". Dhe një përshtypje e fundit. Në anën e mëngjërësh pas dy deputetë që janë drejtpërdrejt nipat e dy hetuesve kryesorë të këtij procesi. Në legjislativën e kaluar po anën e mëngjërësh ishte djali i kryehetuesit e kryexhelatit të procesit në fjalë. Ujërat rrjedhin gjithnjë atje ku duhet".



Gjyshi i pushkatuar, Alizoti: Eshtrat s'u gjenden kurrë

Demokrati Tomor Alizoti, ish-drejtes i Departamentit të të Përndjekurve në PD, kujtoi dje 70-vjetorin e asgjësimit nga regjimi komunist, dënimin me varje të gjyshit të tij, si pjesë e grupit të deputetëve që u eliminuan. Riza Alizoti ishte pjesë e deputetëve të dënuar me ekzekutim 70 vite më parë nga regjimi komunist. Për këtë ngjarje ditën e sotme është mbajtur dhe një seancë solemne në Kuvendin e Shqipërisë. Me një shënim në faqen e tij në "Facebook", ai kujton gjyshin e tij, ish-deputet, Riza Alizoti, që jo vetëm u dënuar me varje, por që edhe sot e kësaj dite nuk i janë gjetur eshtrat. "Sot para 70 vjetësh, gjyshi im Riza Alizoti u dënuar me varje nga regjimi komunist. Grupi i deputetëve. Ekzekutimi u krye në Kuçovë. Eshtrat nuk u gjetën kurrë...", shkruan Tomor Alizoti.



Parlamenti seancë të posaçme, kujtohet 70-vjetori i ekzekutimit të deputetëve opozitarë

Hapja e dosjeve, Rama: Krenar! Basha: Ndjem i turpëruar

PD, fond për dokumentimin e krimeve komuniste

Valentina Madani

Seanca e djeshme plene nisi ndryshe. Parlamenti iu kushtua deputetëve të parë opozitarë të diktaturës komuniste. 70-vjetori i ekzekutimit të tyre u përkujtua dje me një seancë të posaçme në parlament nën moton "Deputetet për deputetet". Në prani të familjarëve të deputetëve të ekzekutuar, kryeministri Edi Rama u shfaq krenar që qeveria e tij mori përsipër të miratonte ligjin për hapjen e dosjeve të komunizmit, që sipas tij ishte hap që e ndan vendin prerazi nga e kaluara komuniste. "Një ligj që më në fund e bashkoi Shqipërinë me vendet që kaluan përmes ferrit komunist, vendosën të ndahen me të duke guxuar të bëjnë dritë mbi të shkuarën. Dhe unë nuk mund të mos jem sot krenar me faktin që jam në krye të një qeverie e shumice që këtë mision e mori përsipër pasi të tjerët para nesh nuk patën kurajën ta merrnin", theksoi z.Rama.



Seanca e djeshme parlamentare në përkujtim të deputetëve të pushkatuar

EDI RAMA

"Një ligj që më në fund e bashkoi Shqipërinë me vendet që kaluan përmes ferrit komunist, vendosën të ndahen me të duke guxuar të bëjnë dritë mbi të shkuarën. Dhe unë nuk mund të mos jem sot krenar me faktin që jam në krye të një qeverie e shumice, që këtë mision e mori përsipër pasi të tjerët para nesh nuk patën kurajën ta merrnin", theksoi z.Rama.

Reagimi



SALI BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha reagoi dje në lidhje me 70-vjetorin e ekzekutimit të 15 deputetëve të parë opozitarë. Ai shkruan se pas 27 vitesh pluralizëm, në qeveri janë pasardhësit e Hitlerit shqiptar të pasluftës dhe bllokmenëve mizorë, duke përmendur emrin e kryeministrit dhe kreut të Kuvendit. Berisha kërkon zotim për të larguar nga pushteti pasardhësit e xhelatëve të parlamentarëve të lirisë.



Bernd Borchardt

Krimet e komunizmit, Borchardt: Regjimet shtypëse bien me revolucion

Regjimet shtypëse bien me revolucion, por ideologjia e tyre mund të vazhdojë nëse ato nuk diskreditohen". Kështu u shpreh ambasadori i OSBE në vendin tonë, Bernd Borchardt gjatë fjalës së tij në parlament me rastin e 70-vjetorit të vrasjes së grupit të deputetëve nga regjimi komunist. "I takon shoqërisë shqiptare dhe këtij parlamenti të vendosë nëse mund të bëhet më shumë në këtë fushë. Ju po njiheni me krimet e së kaluarës dhe po i dënoni ato. Kjo arrin përmasa shndërruese, sepse pranimi publik kontribuon në çlirimin e shoqërisë. Ekspozimi i shkeljeve i damkos shkelësit, duke i syrgjynosur në të kaluarën e hidhur. Në vendin tonë u dëshën 47 vjet për ta arritur këtë vendim. Regjimet shtypëse bien me revolucion ose me përmbyse, por ideologjia e tyre mund të vazhdojë nëse ato nuk diskreditohen. Ju shpallni qëndrimin e përbashkët politik dhe ndani të njëjtën vetëdije politike me votuesit tuaj. Kjo vetëdije që shpall atë që ishte e gabuar e ndan edhe më shumë shoqërinë nga regjimi i mëparshëm", tha Bernd Borchardt.

LULZIM BASHA

"Ne duhet të gjejmë dhe të identifikojmë të gjitha eshtrat e viktimave të komunizmit, të nderojmë martirët e pluralizmit shqiptar, të tregojmë krimet e komunizmit dhe historinë tragjike se si një popull i tërë ra në kthetrat e komunizmit, t'u presim rrugën njëherë e mirë drejtuesve të lartë komunistë nga drejtimi i vendit dhe të ndalojmë përdorimin e simboleve komuniste", tha z.Basha.

Deputetët e ekzekutuar, Strazimiri: Po i vrasim sërish

Deputeti i PD-së, Genti Strazimiri akuzoi se si i biri Kristaq Ramës, apo pasardhës i shefave të Sigurimit të Shtetit vazhdojnë të jenë sot në parlament dhe janë ulur krah bijve e nipave të viktimave. "Po rivrasim sërish pas 70 vjetësh 'grupin e deputetëve', në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, nën kujdesin e veçantë të Gramoz Ruçit! Fjalën e rastit po e mban i biri i Kristaq Ramës, nën vëmendjen dhe pjesëmarrjen emocionuese në sallë, të bijve krenarë të Sulë Bushatit, Llambi Gegpriftit dhe të shefave të Sigurimit të Shtetit, ulur krah për krah me bijtë e nipat e viktimave... Në një paqe më makabre se vetë krimi po përkujtojmë me nderim si 'reflektim' krimin... jo heronjtë në varre!", shkruan deputeti i PD.



të ndryshojë. Ai numëroi 5 pikat e platformës së demokratëve lidhur me gjithë sa duhet bërë për ta çliruar vendin nga e shkuara dhe për të hedhur dritë rreth së vërtetës historike, që mbahet ende në errësirë. Zotimet e Bashës

janë: "Të gjejmë dhe identifikojmë eshtrat e viktimave të pazbuluara. Të nderojmë emrat e martirëve të vërtetë të demokracisë dhe pluralizmit dhe t'i kujtojmë ata që të rrëfijnë jetën, tragjeditë. Duhet të tregojmë krimet e komunizmit dhe historinë



Sula, deputetëve:
Të gjithë brenda
këmishave të kolegëve

Autoriteti për hapjen e dosjeve ka arritur të zbardhë të gjitha materialet arkivore që ekzistojnë për gjyqin e zhvilluar ndaj 21 deputetëve të dënuar, 15 prej të cilëve u pushkatuan, pasi iu kundërvunë kufizimit të lirive, duke u akuzuar si pro-perëndimorë. "Është një fitore e të gjithë shoqërisë shqiptare që dita e kujtesës së mendimit të lirë të themelohet sot, së pari në tempullin e fjalës, në parlamentin shqiptar. Jam shumë e sigurt që deputetët e sotëm të Kuvendit të Shqipërisë, pavarësisht nëse u përkasin minorancave apo mazhorancës, sot ndihen të gjithë brenda këmishave të kolegëve të tyre historikë, të torturuar e vrarë jo shumë kohë më parë", deklaroi Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit për Hapjen e Dosjeve.

tragjike se si një popull ra në kthetrat e komunizmit. T'u presim rrugën njëherë e mirë drejtuesve të lartë komunistë nga drejtimi i vendit. Ndallim publik të shenjave dhe simboleve të figurës së Enver Hoxhës dhe komunizmit".

KRIMINALITETI SITUATA

Kriminaliteti në vend, ish-kryeministri nxjerr emrat: Kriminelët, në çdo vend

Valentina Madani

Ish-kryeministri Sali Berisha lëshoi dje, akuza të forta në adresë të kryeministrit Rama për situatën e krimit në vend. Ai postoi mesazhet e qytetarëve dixhitalë dhe shkruan se "Vrasës serialë, banda të armatosura me makina të blinduara, kokainë, të lidhura direkt me Edvinin, bëjnë ligjin në çdo shesh, rrugë, rrugicë, biznes të Shkodrës". "Shkodra, më keq se kurrë në kthetrat e bandave të Noriegës! Vrasës serialë, banda të armatosura me makina të blinduara, kokainë të lidhura direkt me Edvinin, bëjnë ligjin në çdo shesh, rrugë, rrugicë, biznes të qytetit!", shkruan ish-kryeministri. Z. Berisha publikon më tej mesazhet e qytetarëve për situatën e kriminalitetit në vend. "Lexoni mesazhet e qytetarëve dixhitalë: 'Para dy ditëve, në qendër të Shkodrës, tek ish-5 heronjtë, policia kishte dalë kontroll duke ndaluar gjithë makinat. Në atë moment kalon një makinë 'ML' blu e errët, e blinduar dhe me xhama të zinj, dhe policia u mobil-

Berisha: Rama, i lidhur me vrasës, banda dhe kokainë

DENONCIMI

"Jam një oficer policie në Komisaratin e Policisë Shkodër. S'mund të japim informacion për një person në kërkim, Artan Dekovi, i dënuar me 12 vjet burgim, pasi është djali i xhaxhait i shefit të SH.Ç.B.A në Drejtorinë e Policisë Shkodër, Arben Dekovi. Ky person lëviz i armatosur në qytet dhe nuk e ndalon njeri, sepse kemi frikë nga shef Arbeni", thuhet në një mesazh drejtuar Berishës.

zua, por kot, sa hapi xhamin zotëria, që quhet Behar Bajri, gjithë policët bënë sikur s'e panë. Faktikisht ai njeri lëviz i armatosur nëpër Shkodër dhe policia nuk bën tentativën më të vogël për ta ndaluar dhe e njohin të gjithë në Shkodër se kush është ai njeri, por askush nuk mund të flasë se ka mbështetjen e politikës", thuhet në denoncimin drejtuar z. Berisha. Një

tjetër mesazh është: "Shkodra gumëzhin tani ditën nga automjetet e blinduara nga kriminelë që kanë bërë shumë vrasje dhe plaçkitje, gjopa dhe shumë të tjera. Janë mbi 20 makina të blinduara që lëvizin nëpër Shkodër me armë brenda. Po këta kriminelë kanë mbushur kutitë e votimit në zgjedhje". Berisha zbardh edhe një tjetër mesazh: "Banda ka në

çdo vend të Shqipërisë. Në Dobraq të Shkodrës ke fisin e Bajrave, ku Enver Bajri është organizatori; jeton prej vitesh në Holandë. I vëllai i tij, Behar Bajri ka bërë mbi 13 vrasje në qytetin e Shkodrës, ku po terrorizon komplet Shkodrën me vënie gjobash me 4 blinda që patrolon në Shkodër. Është banda që iu bënte presion qytetarëve të votojnë PS-në, ose përndry-

she do shkelen me këmbë. Kanë lidhje direkt me Edi Ramën këto plehra". Një tjetër denoncim është nga Elbasani: "Duke marrë shkas nga ngjarjet e fundit që po ndodhin, mora shkas të shkruaj: Të gjithë flasin për Elbasanin, por vetëm z. Alibeaj në TV e përmendi Shkodrën. Aty është banda shumë e rrezikshme, që vepron dhe jep para me fajde pa kontratë, sepse të vret dhe kanë aq shumë para, saqë kanë financuar edhe në zgjedhjen e deputetit, z. Luan Harusha, që mund të jetë çun i mirë, por është financuar nga ata! Kisha dëshirë t'i bëja një pyetje z. Harusha: A e keni numrin e telefonit të Behar dhe Enver Bajrit në telefonin tuaj?".



Gjatë një seance parlamentare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË Institucioni i Presidencës

Kolegji i Posacëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, shpall vendet vakante për

7 (SHTATE) KËSHILLTARË LIGJORË DHE 3 (TRE) KËSHILLTARË EKONOMIKË.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkeses nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë", Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 Nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".



OPOZITA

Në takimin që pati me Danielsson, Genc Pollo i tha se përmbushja e kushteve të vendosura nga BE-ja, si lufta kundër krimit të organizuar me pleksje politike veçanërisht të narkotrafikut, lufta kundër korrupsionit, mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe dekriminalizimi, janë shërbimi më i mirë për popullin shqiptar. "Sidomos kur qeveria paraqitet si pengesë. Thënia e të vërtetave dhe trysnia politike nga Brukseli është mënyra më e mirë për të ndihmuar", - u shpreh Pollo.



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

"Mjekët të vizitojnë sa më parë Ramën"

Kryemadhi: Meta ka shërbyer si antiplumb për kryeministrin

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi lëshoi akuza të forta ndaj ish-aleatit të saj, kryeministrit Edi Rama. Në një intervistë për "TPZ.AL", Kryemadhi konfirmoi se partia e saj po rakordon edhe me pjesën tjetër të opozitës, Partinë Demokratike, për aksionet politike që do të ndërmerren në Parlament. Në lidhje me shëndetin mendor të kryeministrit Edi Rama, që është bërë objekt i shumë diskutimeve, Kryemadhi u shpreh se ajo nuk është një mjekje apo psikologe, por se mjekët duhet t'i bëjnë një analizë kryeministrit. "Unë nuk jam as psikologe dhe as terapistë, por unë mendoj që do të ishte më mirë të pyeten mjekët për t'i bërë një analizë z. Rama. Nga ajo që unë shikoj, ndjej, dhe nga ato çfarë kemi nga eksperiencat tona të përbashkëta, Rama është një personazh, i cili kërkon që përgjegjësinë t'ua lërë të tjerëve. Ka frikë. Ka frikë nga zullumet që ka bërë", - u shpreh ajo. Kryemadhi u shpreh se Rama e përdori LSI-në për të mbrojtur veten nga grupimet brenda Partisë Socialiste. "Gjatë katër viteve të kaluara, Rama, çdo kërcënim që u bënte grupeve brenda partisë së vet, u thoshte, 'unë kam LSI-në, kam Ilir Metën, nuk më interesoni ju'. Tashmë nuk ka më LSI-në, se Ilir Metën edhe mund ta ketë, pasi ai është President. Kam parasysh firmosjet e dekreteve që z. Meta i bëri menjëherë pa kaluar sekonda. Nëse deri dje, LSI-ja dhe Ilir Meta ishin një mburojë 'antiplumb' ndaj qëndrimeve apo sulmeve që i bëheshin z. Rama, sot ai nuk ka gjë tjetër më. Të vetmen mburojë që ka janë bandat e krimit të organizuar; oligarkët, të cilët i ka shtruar në tepsinë e tij qeverisëse. Çdo grup oligarkësh apo çdo grup mafioz kanë përfaqësuesit e tyre në ministri, për të ndjekur aferat e tyre korruptive dhe për të ndjekur gjithë procesin e tyre", - u shpreh Kryemadhi.

Krerët e shtetit presin drejtorin e Negociatave në BE, Danielsson

Meta: Të ngrihen organet e vetingut, reforma zgjedhore të nisë në kohë

Zyrtari i lartë bisedon me Ramën e Xhafajn për integrimin

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dje në takim, Drejtorin e Përgjithshëm për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociatat e Anëtarësimit në Komisionin Evropian, z. Christian Danielsson. Sipas njoftimit për shtyp të Presidencës, presidenti Meta theksoi rëndësinë që ka përmbushja e 5 prioritetëve të Komisionit Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimit dhe u shpreh optimist për plotësimin në kohë të tyre. Ai nënvizoi gjithashtu, se pritisshmëritë legjitime të qytetarëve shqiptarë dhe investimi i madh evropian dhe amerikan për reformën në drejtësi duhet të njohin përparim cilësor dhe të shpejtë, në ngritjen e plotë dhe funksionimin efikas të organeve që do të bëjnë rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Presidenti Meta theksoi gjithashtu, rëndësinë që ka nisja në kohë e reformës zgjedhore në Kuvendin e Shqipërisë, për të trajtuar me seriozitet dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha shqetësimet dhe rekomandimet që ngrihen në raportin e OSBE/ODIHR-it. Presidenti Meta dhe zoti Danielsson shkëmbyen mendime edhe mbi situatën në rajon dhe zhvillimet e fundit në Bashkimin Evropian. Drejtori i Përgjithshëm për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit në Komisionin Evropian, Christian Danielsson, ka zhvilluar takime me krerët e lartë të shtetit, gjatë ditës së dytë të vizitës së tij në Tiranë. Danielsson u takua dje, edhe me kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Temë diskutimi mes tyre mësohet se ka qenë rrugëtimi i Shqipërisë drejt integrimit në BE. Gjithashtu, zyrtari i lartë i BE-së, u takua edhe me kryetarin e Komisionit të Integrimit Evropian në Kuvend, Genc Pollo. Duke e falënderuar për ndihmën e deritanishme, Pollo i tha zotit Danielsson se përmbushja e kushteve të vendosura nga BE-ja, si lufta kundër krimit të organi-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta në takimin e djeshëm me drejtorin e Përgjithshëm për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociatat e Anëtarësimit në Komisionin Evropian, z. Christian Danielsson

HAPET KONSULLATA SHQIPTARE NË MILANO

Kryeministri Edi Rama informoi dje, hapjen e Konsullatës Shqiptare në Milano, ndërsa premtoi çeljen e të tjera stacioneve dinitoze për shërbimet konsullore në botë. "U ngritën sot edhe flamujt në godinën e re të Konsullatës Shqiptare të Milanos. Në vijim do të çelim të tjera stacione dinitoze e të përbashkëta për shërbimet konsullore për shqiptarët nëpër botë", shkroi kryeministri Rama në rrjetin social "Facebook", ndërsa publikoi edhe një foto nga godina e re e Konsullatës Shqiptare në Milano.

9 minoritete, projektligji shkakton përplasje mes deputetëve

Debatet te "Ligjet", bullgarët pakicë kombëtare në Shqipëri

Bullgarët që jetojnë në vendlin tonë tashmë do të njihen si pakicë kombëtare. Komisioni i Ligjeve e përfshiu këtë minoritet në listën e pakicave kombëtare, duke e çuar numrin total të tyre në 9. Pas disa ditë diskutimesh në mbledhjet e Komisionit të Ligjeve, edhe dje, deputetët janë përplasur me njëri-tjetrin. Relatori i projektligjit, Bledi Çuçi tha: "Ka dhe një letër nga disa deputetë europarlamentarë që kërkojnë futjen e pakicës bullgare në listën ku numërohen pakicat kombëtare në Shqipëri". Sipas tij, ky proces është bazuar te vetëdeklarimi dhe censuset e realizuara ndër vite. Ndërsa deputeti i PD-së, Gent Strazimiri u shpreh: "Është një letër e Komisionerit Kundër Diskriminimit në Parlamentin Evropian. Nuk është kriter ligjor për t'u shpallur pakicë". "Mos ndoshta rrezikojmë që të dalim me



Prespën, Gollobordën dhe Gorën me 24 mijë e 212 persona që jetojnë në fshatra dhe janë pakicë maqedonase, dhe njëkohësisht kemi 24 mijë e 212 persona, ekzakta e njëjta shifër që janë pakicë bullgare? Nga të dhënat që disponohen nga censuset në Republikën e Shqipërisë, nuk kemi asnjë të dhënë për pakicë bullgare". Nga ana e tij, Edmond Panariti i LSI-së theksoi: "Duhet të respe-

MINORITETET NË SHQIPËRI

- Greke
- Maqedonase
- Vllaha/Aromune
- Rome
- Egjiptiane
- Malazezze
- Boshnjake
- Serbe
- Bullgare

ktojmë edhe institucionet shqiptare: Akademinë e Shkencave, e cila duhet të shprehë në mënyrë institucionale". Debatu nuk mungoi as sa i përket nenit 14 të ligjit që parashikon përdorimin e gjuhës së pakicës kombëtare, krahas asaj shqipe në administratë, në bashkitë ku ata banojnë tradicionalisht ose përbëjnë 20% të banorëve.

zuar me pleksje politike veçanërisht të narkotrafikut, lufta kundër korrupsionit, mbajtja e zgjedhjeve të

lira dhe dekriminalizimi, janë shërbimi më i mirë për popullin shqiptar. "Sidomos kur qeveria paraqitet si pengesë.

Thënia e të vërtetave dhe trysnia politike nga Brukseli është mënyra më e mirë për të ndihmuar", - u shpreh Pollo.

DEKLARIMI PASURIA

Zbardhen deklarimet e grave në kuvend e qeveri, kreditë që u shlyen gjatë vitit 2016

Pasuria e ministereve dhe deputeteve, nga apartamentet te llogaritë bankare

Ligjvënëset socialiste të Fierit, pronare të qindra metrave tokë

Darina Tanushi
Gazeta Shqiptare" zbardh sot, pasurinë e një pjese të deputeteve që janë rimanduar nga zgjedhësit dhe partitë e tyre, në legjislaturën e re të Parlamentit. Nderkohë, deputetet që kanë marrë më 25 qershor mandatin e tyre, pritet që deklarimin e pasurisë ta bëjnë në muajt në vijim, sipas afateve të caktuara nga ILDKP-ja.

proces të marrjes së një kredie për shlyerjen e detyrimeve sipas kontratës së blerjes së një apartamenti banimi 2+1 në Tiranë, për të cilin ka parapaguar 19 000 euro në vitin 2012. Ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu ka deklaruar se është bashkëpronare në dy apartamente banimi në Tiranë. Bashkëshorti i saj deklaroi se ka disa llogari bankare, por edhe kredi për blerje apartamenti. Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi deklaroi se shiti 3 apartamente vite më parë dhe ndryshimi në llogaritë bankare.



DEKLARIMET

Deputetet që kanë marrë më 25 qershor mandatin e tyre, pritet që deklarimin e pasurisë ta bëjnë në muajt në vijim, sipas afateve të caktuara nga ILDKP-ja.

PASURIA E MINISTREVE DHE DEPUTETEVE

ADELINA RISTA

Të ardhura nga paga dhe përfitimet të tjera financiare si deputete, 3 379 659 lekë.

Pasuri të paluajshme

- 1) Tokë truall 560 m2, në zonën kadastrale 8533, kthyer nga Komisioni i Kthimit të Pronave. Pjesa në zotërim e znj. Rista 50%.
2) Shtëpi banimi 2 kate me sipërfaqe totale 264.5 m2, ndërtuar mbi tokën truall. Ndërtesa është financiar nga shitja e 610 m2 truall, pronë e kthyer nga Komisioni i Kthimit të Pronave si dhe nga shitja e materialeve pas prishjes së shtëpisë ekzistuese. Pjesa në zotërim e znj. Rista 50%.
Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrethëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)

- 1) Depozitë kursimi me vlerë 450 100 lekë. Pjesa në zotërim e znj. Rista 50%.
Automjete
2) Zotërim i një automjeti, për të cilin nuk është deklaruar vlera përkatëse. Pjesa në zotërim e znj. Rista 50%.

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare
Bashkëshorti, z. Kostandin Rista, të ardhura nga pensioni i pleqërisë, 178 191 lekë. Gjendje depozitë bankare së bashku me bashkëshortin, 503 232 lekë.

ALBANA VOKSHI

Të ardhura nga paga dhe përfitimet të tjera financiare si deputete, 2 519 766 lekë.

Gjendja e llogaritë

- 1) Gjendje e llogarisë bankare më 31 dhjetor, pakësuar me 32 dollarë.
2) Gjendje e llogarisë bankare më 31 dhjetor, pakësuar me 18 dollarë.
3) Gjendje e llogarisë bankare më 31 dhjetor, pakësuar me 12 dollarë.
4) Gjendje e llogarisë bankare më 31 dhjetor, pakësuar me 738 584 lekë.
5) Gjendje para cash, 500 000 lekë.
6) Gjendje e llogarisë bankare më 31 dhjetor, shtuar me 860 euro.

Detyrime

Shlyer në vitin 2016 vlerën -3 117 euro për kredi bankare me principal 34 000 euro, për të cilin më 31 dhjetor mbeten pa shlyer 12 392 euro.

ANTONETA DHIMA

Pasuri të paluajshme

- 1) Bashkëpronare me 86% i një toke arë me sip. 450 m2 dhe tokë truall me sip. 250 m2, prej së cilës 75 m2 i zë ndërtesa, Fier.
2) Bashkëpronare me 86% i një toke arë me sip. 4 685 m2 në Fier.
3) Bashkëpronare me 86% i një toke arë me sip. 11 831 m2 në Fier.
4) Bashkëpronare me 86% i një toke arë me sip. 1 440 m2 në Fier.
5) Bashkëpronare me 86% i një toke arë me sip. 2 160 m2 në Fier.

Të ardhura nga paga dhe përfitimet të tjera financiare si deputet, 3 036 741 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare

- 1) Bashkëshorti, z. Panajot Dhima, paga pranë "Albpetrol sha", 1 068 475 lekë.
2) Bashkëshorti, paga si ekonomist me kohë të pjeshme në qendrin "Epoka e Re", 166 66 lekë.
3) Bashkëshorti, paga si Ndërmjetës në Sigurime, 111 euro.
4) Djali, interesa bankare, 1 736 lekë.

BLERINA GJYLAMETI

Të ardhura nga paga dhe përfitimet në funksionin e deputetit, 2 519 142 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare

- 1) Bashkëshorti, të ardhura nga paga 960 000 lekë.
2) Bashkëshorti, të ardhura nga aktivitet privat, 332 669 lekë.
Të Ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka
Të tjera
1) Kursime nga paga vjetore, 560 000 lekë.
2) Bashkëshorti, kursime nga të ardhura vjetore, 368 000 lekë.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME 2016

- 1) Bashkëshorti, shlyer në vitin 2016 -266 309 lekë për kredi konsumatore marrë më 31.12.2013 me principal 980 000 lekë, kështu mujor 22 192 lekë dhe afat shlyerjeje 5 vjet. Detyrimi i mbetur më 31 dhjetor është 435 073 lekë.
2) Bashkëshorti, shlyer në vitin 2016 -6 120 euro për kredi për blerje shtëpie. Detyrimi i mbetur më 31 dhjetor është 96 383 euro.

Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrethëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)

- 1) Gjendje cash 20 000 euro, krijuar nga të ardhurat ndër vite, pjesë e regjimit martesor.
2) Gjendje cash 900 000 lekë, krijuar nga të ardhurat ndër vite, pjesë e regjimit martesor.
3) Llogari bankare me vlerë 16 734 lekë, krijuar nga të ardhurat personale. Pjesa e znj. Gjylameti 100%.
4) Detyrim overdrifti 129 537 lekë.
5) Z. Gjylameti, gjendje e llogarisë bankare 15 euro.

Automjete

- 1) Bashkëshorti, z. Kostika Gjylameti zotëron një automjet me vlerë 6 500 euro, blerë në vitin 2011 me të ardhurat personale.
2) Z. Gjylameti zotëron automjet me vlerë 2 500 euro, blerë në vitin 2006 me të ardhurat personale.

EGLANTINA GjERMENI

Të ardhura nga paga si ministre pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, 1 566 461 lekë.

Të ardhura si Këshilltare/Anëtare Bordesh

- 1) Paga për pjesëmarrje në KKT, 169 400 lekë.
2) Paga për pjesëmarrje anëtare e bordit FSHZ, 28 702 lekë.
Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare
1) Bashkëshorti, Marian Gjermeni, paga dhe shpërblime si Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare Banka e Shqipërisë 3 863 278 lekë.
2) Bashkëshorti, interesa neto nga investimet në Letra me Vlerë në Lek, 853 023 lekë.
3) Djali, Erik Gjermeni, paga si Specialist në "Business Integration Partners", dega Londër, 17 987 pound britanik.

Të tjera

- 1) Bashkëshorti Marian Gjermeni, gjendje llogarisë bankare, pakësuar me 28 479 lekë.
2) Bashkëshorti, gjendje e llogarisë bankare, shtuar me 10 037 dollar.
3) Bashkëshorti, gjendje e llogarisë bankare, shtuar me 2 400 pound britanik.
4) Bashkëshorti, gjendje e llogarisë bankare, shtuar me 6 111 euro.
5) Bashkëshorti, gjendje e llogarisë bankare, pakësuar me 1 904 euro.
6) Bashkëshorti, gjendje e llogarisë bankare, pakësuar me 101 234 lekë.
7) Bashkëshorti, gjendje e parave kesh, shtuar me 2 000 pound britanik.
8) Bashkëshorti, gjendje e parave kesh, pakësuar me 1 000 euro.
9) Bashkëshorti, blerë monedha me vlerë 150 000 lekë.
10) Gjendje e llogarisë bankare, shtuar me 48 063 lekë.
11) Djali, Erik Gjermeni, gjendje llogarisë bankare, shtuar me 691 pound britanik.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME 2016

Bashkëshorti, shlyer për vitin 2016 -205 294 lekë për kredi për shtëpi, për të cilin më 31 dhjetor mbeten pa paguar 3 147 847 lekë.

ERMONELA FELAJ

Të ardhura nga paga si ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin, 1 566 456 lekë.

Të ardhura nga interesa depozitë bankare, 30 euro, pjesë e regjimit martesor.

Të ardhura nga cellet trashëgimi nga nëna e ap. banimi me sip. 50 m2, 1/8 pjesë lakuese, e cila sipas kontratës së shijës të datës 04.02.2016 ka një vlerë prej 1 100 000 lekësh dhe i është dhuruar babait.
Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare
1) Bashkëshorti Bledar Valiqaj, të ardhura nga paga si Officer Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, 960 743 lekë.
2) Bashkëshorti, të ardhura nga interesa depozitë bankare, 2 340 lekë.

Të tjera

Gjendje llogarisë bankare nga paga e dy bashkëshortëve, 2 450 797 lekë.

EVIS KUSHI

Pasuri të paluajshme

- 1) Pronar me 100% i një apartamenti banimi me sip. 71 m2 në vlerën 1 900 000 lekëve.
2) Pronar me 100% i një apartamenti banimi me sip. 99.18 m2 në vlerën 37 700 euro, për të cilin janë paguar 33 000 euro.
3) Bashkëshorti zoti Florenc Kushi, pronar me 100% i një trualli me sip. 500 m2 në Kavajë, në vlerën 300 000 lekë.
Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrethëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)
1) Llogari bankare në vlerën 387 926 lekë.
2) Para Kesh (Cash) në vlerën 1 000 000 lekë.
3) Bashkëshorti zoti Florenc Kushi, llogari bankare në vlerën 16 644 lekë.

Automjete, pronar me 100% i një veture tip "Skoda Octavia" në vlerën 14 500 euro.

Të ardhura nga paga dhe përfitimet të tjera financiare si deputet, 2 944 023 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare

- 1) Bashkëshorti, të ardhura nga paga si specialist sporti pranë Bashkisë Elbasan, 1 janar - 3 maj 2016, 241 446 lekë.
2) Bashkëshorti, të ardhura nga paga si specialist sporti pranë Bashkisë Elbasan, 1 Maj - 31 Dhjetor 2016, 350 534 lekë.
3) Bashkëshorti, të ardhura nga paga si pedagog i jashtëm pranë Universitetit "Aleksander Xhuvani", 128 220 lekë.

Të tjera

- 1) Gjendje llogari bankare më 31 dhjetor, 380 378 lekë.
2) Kursyer gjatë vitit 2016, 800 000 lekë.
3) Bashkëshorti, gjendje llogari bankare më 31 dhjetor, 9 394 lekë.
4) Bashkëshorti, gjendje llogari bankare më 31 dhjetor, 7 252 lekë.
5) Bashkëshorti, dhuruar të motrës 13 pjesë të shtëpisë me sip. 73 m2 në Elbasan, trashëguar nga prindërit.

JORIDA TABAKU

Të ardhura nga paga, përfitimet e tjera financiare dhe bonuset si deputete, 2 462 965 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare

- 1) Bashkëshorti, të ardhura nga paga dhe shpërblime si pedagog në Fakultetin e Ekonomisë, Universitetit të Tiranës, 762 068 lekë.
2) Bashkëshorti, të ardhura nga pagesa si anëtar i bordit të bankës "Credins", 4 250 euro.
3) Bashkëshorti, të ardhura nga REPIM, UK, 2 588 pound britanik.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME 2016

Detyrime të paguara nga prindërit në vlerën -15 175 euro për kredi bankare për shtëpi me principal 130 000 euro, afat maturimi 10 vjet dhe kështu mujor 1 385 euro. Detyrimi i mbetur më 31 dhjetor është 15 783 euro.

KEJDI MEHMETAJ

Psasuri të paluajtshme
1) Babai, zoti Fatmir Mehmetaj, pronar me 100% i një truallii me sip. 4 000 m2 dhe i një shtëpie me sip. 200 m2 në Mallakastër, blerë në vitin 2002, në vlerën 8 000 000 lekë.

KLODIANA SPAHIU

Të ardhura nga paga, përfitimet e tjera financiare dhe bonuset si deputete, 2 728 345 lekë.
Të ardhura nga paga për mësimdhënie në Universitetin "Zoja e Këshillit të Mirë", 1 275 euro.

MIMI KODHELI

Të ardhura nga paga si ministere e Mbrojtjes, 1 566 461 lekë.
Të ardhura nga interesa bankare dhe kredidhënies
1) Të ardhura nga interesa depozite, 2 962 lekë, pjesa takuese 50%.

MONIKA KRYEMADHI

Psasuri të paluajtshme
1) Apartamenti me sip. 200 m2, vlerë 400 000 euro, në Rr. "Brigada 8", Tiranë. Burimi: 200 000 euro është financuar nga shtjta e një shtëpie pushimi në Qerret, pjesa tjetër me kredi.

blerje apartamenti.
4) Detyrimi për kartë krediti minus 600 euro.
Autometje
Automjet me vlerë 33 954 euro, blerë në vitin 2005.

OLTA XHAÇA

Të ardhura nga paga dhe dieta si deputete, 2 528 836 lekë.
Të tjera
Në proces marje kredie për shlyerjen e detyrimeve sipas kontratës së blerjes së një ap. banimi 2+1 në Tiranë, për të cilën ka parapaguar 19 000 euro në vitin 2012.

VASILIKA HYSI

1) Të ardhura nga paga dhe përfitime të tjera financiare si deputete, 2 205 038 lekë.
2) Të ardhura nga mësimdhënie dhe udhëheqje doktoraturash pranë Fakultetit të Drejtësisë, UT, 382 688 lekë.

KLAJDA GJOSHA

1) Llogari bankare në bankë të nivelit të dytë në vlerën 80 086 lekë.
2) Bashkëjtuesi, zoti Gjoni, llogari bankare në bankë të nivelit të dytë në vlerën 585 089 lekë.

LINDITA NIKOLLA

Të ardhura neto nga paga si ministere e Arsimit dhe Sportit, 1 559 561 lekë.
Të ardhura nga Bonuse Të ardhura neto nga honorare, 90 000 lekë.

4) Vajza, zot. Livia Nikolla, të ardhura nga paga neto si Specialiste në Departamentin e Stabilizimit Financiar në Bankën e Shqipërisë, paga mujore 73 838 (nuk specifikohen muajt e punës vjetore, 886 056 lekë).

MILVA EKONOMI

Të ardhura bruto nga paga si ministere e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, 1 669 509 lekë.
Të ardhura si Këshilltare/Anëtare Bordesh
1) Të ardhura neto nga anëtarësia në bordin e KKT, 23 200 lekë.

MIRELA KUMBARO

Të ardhura nga paga si ministere e Kulturës, 1 566 456 lekë.
Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies
1) Të ardhura nga interesa depozite, 143 euro, pjesa takuese 50%.

OGERTA MANASTIRLIU

Psasuri të paluajtshme
1) Bashkëpronare me 50% e një ap. banimi me sip. 71.4 m2 në Tiranë, blerë në vitin 2005 me kredi bankare, 38 700 euro.

Harta e vlerës së tregut për Tiranën dhe të gjitha qarqet

Ahmetaj: Ja formula e re për taksimin e shtëpive

Ministri publikon shembujt, ja sa paguani për banesat

Ornela Manjani

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, në një dalje para mediave deklaroi se aktualisht është gati drafti final për taksën e pronës, e cila nis zbatimin nga 1 janari 2018. Taksimi do të bëhet sipas vlerës së tregut të pasurisë dhe jo sipas çmimit fik, por ministri nuk dha detaje se sa do të jetë përqindja që do të aplikohet. "Ministria e ka të detajuar draftin për taksën e pronës dhe nuk do të ketë nivel të diferencuar për shtëpitë e dyta. Ajo që përmban është kalimi nga taksë fikse, në referencë të vlerës. Pra, nëse një shtëpi u është referuar gjithmonë çmimeve minimale fiskale dhe mbi të është vendosur një taksë fikse, tani do të kalojmë në nivelin e vlerës reale të shtëpisë. Po marr një shembull: shtëpia juaj nuk është 800 euro metri katror, por në fakt është 1200 euro metri/katror, kjo në bazë të transaksioneve. Mbi këtë vlerë reale do të aplikohet përqindja e taksës. Është një proces që s'do bëhet që në 1 janar 2018, por nis nga 1 janari. Në harkun e dy viteve do të kemi një kadastrë fiskale që do të jetë në favor të vlerës reale të pronës dhe bashkive, që edhe e përfitojnë këtë taksë. Edhe një herë, për të qenë të qartë, nuk do të ketë tarifë të diferencuar", - tha Ahmetaj.

FORMULA

Formula për taksimin e shtëpive do të ndryshojë. Ministria e Financave po përgatit një draft, sipas të cilit taksë mbi pronën do të llogaritet në bazë të çmimit të referencës, i cili caktohet nga qeveria. Taksë e banesave, që prej 1 janarit do të ndryshojë, dhe sipas llogaritjeve pritet të jetë më e lartë se ajo që aplikohet aktualisht. Si argument për ndryshimin e formulës që taksimit, është fakti se duhet të kalohet në një sistem



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

ÇMIMET E REFERENCËS PËR TË GJITHA ZONAT NË TIRANË

| | |
|--|-----------------------------|
| Xhamlliku, Profarma, Rr. "Bardhyl", Rr. "Kongresi i Manastirit" | 77.000 lekë/m ² |
| Porcelan, Kinostudio, Rr. "Hoxha Tasim", fshati Linzë | 60.000 lekë/m ² |
| Kompleksi i Spitalëve, SHIK, Oxhaku, Allias, Tufinë | 70.000 lekë/m ² |
| Rr. "Njazi Meka", Bregu i Lumit, Allias i Ri, "Myslim Keta" | 60.000 lekë/m ² |
| Ish-Biloku, Libri Universitar, "Vodafon" | 190.000 lekë/m ² |
| Stadiumi "Selman Stermasi", Liqeni Artificial | 132.000 lekë/m ² |
| Kopshiti Botanik, Rr. "Komuna e Parisit", Liqeni Artificial | 107.000 lekë/m ² |
| Hotel "Diplomat", biloku "Vasil Shanto", Selitë e vogël | 82.000 lekë/m ² |
| Shkolla Teknologjike, Kombinati, Vaqarr, Selitë, Yzberisht, Sharrë | 65.000 lekë/m ² |
| Gjykata e Rrethit, ish-Ekspozita | 72.000 lekë/m ² |
| Bar "Piazza", Blloku gjatë rrugës "Zogu i Parë", rr. "Fortuzi" deri te "Mine Peze" - 130.000 lekë/m ² | |
| Stacioni i Trenit, Arkiva e Përgjithshme, Hipoteka | 100.000 lekë/m ² |
| "Don Bosko", Fabrika e Këpuçëve, Bregu i Lumit, Rr. "Siri Kodra" | 77.000 lekë/m ² |
| PTT, Telekomit, ish-Lidhja e Shkrimtarëve | 145.000 lekë/m ² |
| "Myslim Shyri", Drejtoria e Policisë, Kisha Katolike | 139.500 lekë/m ² |
| Ish-biloku i ambasadave, Prokuroria, "Rruga e Durrësit" | 102.000 lekë/m ² |
| Ferluti, ish-uzina Tirana, Shkolla e Parisit | 87.000 lekë/m ² |
| Laparakë, Drejtoria e Doganave, Bregu i Lumit, Fushë Mëzez, "Don Bosko" | 70.000 lekë/m ² |

të taksës mbi pasurinë, e cila bazohet në vlerë, që do të thotë se, ai që ka shtëpi më të mirë, do të paguajë një taksë më të lartë. Ende nuk është vendosur se sa do të jetë taksë e re, ndërkohë që sot paguhet nga 15 deri 30 lekë për m². Ndërkohë, rritje më të ndjeshme të taksës do të ketë për ata qytetarë që kanë më shumë shtëpi. Ministria e Financave pret që taksë e pronës të arkëtohet në bazë të kadastrës fiskale, e cila do të regjistrojë të gjitha pronat e patundshme sipas vlerës së tyre.

ÇMIMET E REFERENCËS NË TIRANË

Çmimet e referencës për Tiranën variojnë, nga 60

mijë lekë për m² deri në 190 mijë lekë/m². Referuar tabelave, çmimi fiskal për shitblerjen e apartamenteve në zonën e ish-Bilokut ka mbetur i pandryshuar. Çmimi i apartamenteve për këtë zonë do të vazhdojë të jetë 190 mijë lekë për metër katror. Sipas tabelave, rritje të çmimit fiskal për shitblerjen e apartamenteve kanë shënuar rruga "Bardhyl", Xhamlliku, Profarma, rruga "Kongresi i Manastirit" dhe bulevardi "Zhan Dark". Qeveria ka shtrenjtuar edhe çmimet e shitblerjeve të apartamenteve për "Rrugën e Durrësit". Në tabelë kjo përkon me zonën kadastrale 3/1, ku çmimi më parë ishte 75 mijë

lekë për metër katror, ndërsa sot bëhet 77 mijë lekë për metër katror, me një rritje prej 2 mijë lekësh për metër katror. Çmimi i referencës për këtë zonë më parë ishte 100 mijë lekë për metër katror, ndërsa bëhet 102 mijë lekë për metër katror, pra rritet 2 mijë lekë. Ndërsa, çmimi fiskal për zonën 1/1, që përfshin "Ali Demin" dhe fshatin Shkozë, është ulur 300 lekë për metër katror. Nga 98 mijë lekë për metër katror, me udhëzimin e ri bëhet 97,700 lekë për metër katror. Ulje modeste ka shënuar edhe çmimi i tregut të apartamenteve në zonën e njohur si "9-katëshet", prej 500 lekësh për metër katror.

| Nr. | Qyteti | lekë/m ² sipërfaqe shfrytëzimi |
|-----------------------------|-----------------|---|
| 1. Qarku Tiranë | | |
| 1 | Tiranë | 89,125 |
| 2 | Vorë | 51,500 |
| 3 | Kamëz | 51,700 |
| 4 | Kavajë | 56,384 |
| 5 | Rrogozhinë | 41,000 |
| 2. Qarku Durrës | | |
| 6 | Durrës | 68,540 |
| 7 | Krujë | 48,500 |
| 8 | Shijak | 41,066 |
| 9 | Sukth | 41,000 |
| 10 | Fushë-Krujë | 51,000 |
| 3. Qarku Shkodër | | |
| 11 | Shkodër | 58,000 |
| 12 | Pukë | 22,000 |
| 13 | Vau Dejës | 24,300 |
| 14 | Koplik | 40,500 |
| 15 | Fushë - Arrëz | 7,500 |
| 4. Qarku Vlorë | | |
| 16 | Vlorë | 59,400 |
| 17 | Oricum | 60,000 |
| 18 | Selenicë | 25,000 |
| 19 | Himarë | 56,000 |
| 20 | Sarandë | 53,300 |
| 21 | Delvinë | 26,750 |
| 22 | Konispol | 28,000 |
| 5. Qarku Korçë | | |
| 23 | Korçë | 45,816 |
| 24 | Pogradec | 49,956 |
| 25 | Bilisht | 35,000 |
| 26 | Ersekë | 26,673 |
| 27 | Maliq | 27,800 |
| 28 | Leskovik | 21,000 |
| 6. Qarku Fier | | |
| 29 | Fier | 53,030 |
| 30 | Lushnjë | 40,100 |
| 7. Qarku Berat | | |
| 31 | Ballsh | 30,100 |
| 32 | Patos | 28,000 |
| 33 | Drivjakë | 49,000 |
| 34 | Roskovec | 30,000 |
| 8. Qarku Elbasan | | |
| 35 | Berat | 41,000 |
| 36 | Kucovë | 38,000 |
| 37 | Polican | 26,000 |
| 38 | Çorovodë | 25,000 |
| 39 | Ura - Vajgurore | 37,300 |
| 9. Qarku Gjirokastrë | | |
| 40 | Elbasan | 50,200 |
| 41 | Librazhd | 44,020 |
| 42 | Cërrik | 38,300 |
| 43 | Gramsh | 43,023 |
| 44 | Peqin | 39,070 |
| 45 | Prrenjas | 41,780 |
| 46 | Belsh | 35,000 |
| 10. Qarku Lezhë | | |
| 47 | Gjirokastrë | 47,860 |
| 48 | Përmet | 36,867 |
| 49 | Tepelenë | 32,500 |
| 50 | Mernalaj | 15,000 |
| 51 | Këlcyzë | 24,600 |
| 52 | Libohovë | 28,400 |
| 11. Qarku Kukës | | |
| 53 | Lezhë | 56,000 |
| 54 | Laç | 42,500 |
| 55 | Mamurras | 31,000 |
| 56 | Rrëshen | 42,000 |
| 57 | Rubik | 29,500 |
| 12. Qarku Dibër | | |
| 58 | Kukës | 53,700 |
| 59 | Bajram Curri | 27,800 |
| 60 | Krumë | 24,500 |
| Komunat | | |
| 61 | Peshkopi | 48,563 |
| 62 | Burrël | 44,357 |
| 63 | Bulqizë | 42,904 |
| 64 | Klos | 32,000 |
| 65 | Komuna Shëngjin | 55,000 |
| 66 | Komuna Milot | 34,200 |
| 67 | Komuna Krrabë | 28,200 |
| 68 | Komuna Kashar | 52,500 |
| 69 | Komuna Dajt | 53,000 |
| 70 | Komuna Farkë | 64,500 |

SHPALLJE ANKANDI
Shoqëria përbarmimore "Corrector" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme.
- Pasuria Njësi me Nr. 3/417- N8, Zona Kadastrale 2364, me sipërfaqe 97.2 m², ndodhur në Laç;
Çmimi i ankandit të tretë është EUR 40,320 (dyzetë mijë e treqind e njëzetë euro).
Ankandi zhvillohet dt. 27/10/2017, ora 16.00 në adresën, Rruga "Kavajes", Ndertesë 27, Hyrja 1, Kati i III -te, Tiranë.
Kontakt: cel. 0684000061, ose në adresën e email: armels.love@nchb.al

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON"
me PËRMBARIMORE GJYQËSORE SUELA METHOXHA
Dt: 12.10.2017 ora 16:00!
Përfundon Ankandit i Dytë për pasuritë:
- Apartamente sip totale 72 m², me adres në Rr. "1 Maji" Korçë,
Me çmim 18 144 Euro
- Apartamente me sip totale 86.03 m², me adresë në Pogradec
Me çmim 3 060 000 Lekë
Ankandi zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

SHPALLJE E ANKANDIT TË PARË
Përbarmuesi Gjyqësor Rrok Deda me adresë Rruga Sulejman Delvina Ndertesë 51, Hyrja 9, App. Nr. 1,prane Hotel "Diplomat" Tirane, njofton shpalljen e ankandit të trete per aksionet e shoqërisë "ENARVI" shpk vetëm 12.85% e aksioneve të vilat janë në pronësi të z. Enea Troka me çmim të shitjes në ankanë në vlerën 10.691.856 (djetë mijë e gjashtëqindëntëdhjetë mijë e tetëqindëpesëdhjetëgjashtë) lekë Personat e interesuar per te marre pjesë ne ankanë ,duhet te paguaje 10% te vleres ne llogarinë me nr. 0000 360 171 ne emer te Rrok G. Deda PF ne banken Raiffeisen. Ankandit mbyllet me dt. 16.10.2017 ne ora 16:00

Ina Allkanjari

Çako: U vura në dijeni nga Lindita Nikolla, unë njoftova ministrin. Rrokaj: Kule s'përmendi emra

Shullazi dhe Tahiri kërkojnë dëshminë e Berishës, Krimet e Rënda e thërrasin në gjyq

Ish-ministri i Brendshëm: Ish-kryeministri më informoi për ngjarjen



Emiliano Shullazi



Saimir Tahiri

Në seancën gjyqësore të zhvilluar dje ndaj të pandehurit Emiliano Shullazi dhe miqve të tij dhanë dëshminë e tyre lidhur me kërcënimin e rektorit Mynyr Koni disa prej personazheve VIP. I akuzuar nga opozita për lidhje të forta me Shullazin përgjatë kohës kur ishte ministër i Brendshëm, Saimir Tahiri u paraqit në gjyq si një prej dëshmitarëve në procesin në ngarkim të të pandehurit. Në rrëfimin e dhënë përpara togave të zeza, Tahiri këmbënguli në thirrjen e ish-kryeministrit Sali Berisha si dëshmitar. Kjo pasi sipas tij, për ngjarjen në fjalë është vënë në dijeni nga një denoncim publik që ka bërë ish-kryeministri. Menjëherë pas largimit të tij nga salla, Shullazi kërkoi të thirret si dëshmitar ish-kryeministri Berisha. Kjo kërkesë erdhi pasi sipas të pandehurit, është i paqartë se si Berisha u vu në dijeni për ngjarjen në fjalë dhe si e identifikoi Shullazin si njërin prej autorëve të kërcënimit të bërë ndaj rektorit Mynyr Koni. Kjo kërkesë mori miratimin e gjykatës. Në mesin e personazhet VIP të thirrur në proces ishte edhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako. Sipas tij, për kërcënimin e kandidatit për rektor u informua nga dikastere të tjera dhe jo nga strukturat e policisë. Ndërkaq, profesor Dhori Kule, i cili ishte i pranishëm në ambientet e gjykatës, njoftoi se për arsye shëndetësore nuk mund të qëndronte, ndaj dëshmia e tij pritet të merret në seancën e radhës.

DËSHMIA E TAHIRIT
I thirrur nga gjykata për të dëshmuar lidhur me kërcënimin e rektorit të Universitetit të Tiranës, Saimir Tahiri u shfaq në sallë në orën e paracaktuar. Ish-ministri ishte krejt i qetë dhe rrëfeu për afro 20 minuta për ngjarjen e ndodhur në

REAGIMI I SAIMIR TAHIRIT

Pas postimit të kreut të PD-së, Lulzim Basha në rrjetet sociale, ka reaguar nëpërmjet një statusi në "Facebook" Saimir Tahiri. "Mirëprita thirrjen e gjykatës për të dëshmuar. Keqardhje për lojën e prokurorisë për të bërë politikë me një proces gjyqësor, që duhet të përfundojë me dënimin e kujtoda që ka kërcënuar kandidatin për rektor. Keqardhje akoma më shumë për Lulzim Bashën, që me sulmet politike po i bën nderin më të madh krimin. Shqipëria do të bëhet më e drejtë, kur lojërat politike të lënë drejtësinë të bëjë drejtësi", shkruan Tahiri.

prill të 2016-ës, kur u kërcënuan dy profesorët Mynyr Koni e Dhori Kule. "Ngjarjen e mësova nga një denoncim publik i bërë nga Sali Berisha. S'e kujtoj sesi unë jam këtu, ndërsa Sali Berishën nuk e keni thirrur. Por kështu është kur prokuroria bën politikë", u shpreh Tahiri. Po ashtu, ai shpjegoi takimin me profesorët Kule dhe Koni në zyrën e tij. "Kam pritur në zyrë dy profesorët, rektorin Dhori Kule dhe kandidatin për rektor Mynyr Koni, min-

istren e Arsimit dhe disa nga drejtuesit e policisë. Dëgjova pretendimet e tyre dhe e adresova çështjen në polici. Profesorët hamendësuan për personat që i kishin kërcënuar. Ne dijeninë e tyre ishin emrat e personave të akuzuar: Nuk thërrisja dot Sali Berishën se s'më përgjigjej. Do ta thërrisja, por ai s'më përgjigjet. Prisja që ta thërrisnit ju, por ju nuk e bëte", rrëfeu Tahiri. Deklarata e tij u mbyll me kërkesën e shtruar ndaj trupit gjyqësor për të thirrur

si dëshmitar në çështjen "Shullazi", ish-kryeministrin Sali Berisha.
DËSHMIA E HAKI ÇAKOS
Një prej personazheve VIP të thirrur nga gjykata për të dëshmuar ndaj Shullazit dhe miqve të tij ishte edhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako. Ai rrëfeu se profesor Dhori Kule e kishte akuzuar Emiliano Shullazin si një nga kërcënuesit e tij. "Në prill të 2016-ës, datën s'e mbaj me saktësi, më telefonoi minis-

trja e Arsimit dhe më informoi për kërcënimin e profesorëve. U takuam në një ambient afër gjykatës Kush-tetuese. Në takim ishte edhe Dhori Kule. U diskutua për një kanosje që i ishte bërë Mynyr Konit. Kule na informoi se kanosja ishte bërë nga disa persona, mes të cilëve ishte dhe Shullazi", deklaroi Çako. Ai theksoi se mori masat e duhura menjëherë pasi u njoftua për ngjarjen, duke vënë në dijeni ministrin e Brendshëm, Saimir Tahirin. Kryepolici shtoi se nuk kishte dijeni për emrat e kërcënuesve, por gjatë bisedës së bërë me Dhori Kulen, ky i fundit ka përmendur se njëri nga personat që e kishin kërcënuar ishte Emiliano Shullazi. Më tej janë thirrur për të dëshmuar në seancën e zhvilluar dje pranë Krimeve të Rënda ish-dekani Shezal Rrokaj, aktualisht deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Ai deklaroi se Dhori Kule e kishte telefonuar duke i kërkuar takim. Sipas tij, profesori i kishin kërkuar të mos mbështeste kandidaturën e Mynyr Konit për rektor, ndryshe do të kishte problem, por nuk kishte asnjë emër të kërcënuesve. Ndërkaq, Majlinda Keta sqaroi para gjykatës se Komisioni i Menaxhimit të Zgjedhjeve për rektor në universitet, unanimisht refuzoi kërkesën për dorëheqje të kandidatit Mynyr Koni,



REAGIMI I LULZIM BASHËS

Pas vendimit të djeshëm të gjykatës për të thirrur si dëshmitar ndaj çështjes "Shullazi" ish-kryeministrin Sali Berisha, kreu i PD-së Lulzim Basha ka reaguar përmes një postimi në rrjetin social "Facebook". "Saimir Shullazi dhe Emiliano Tahiri në sintoni të plotë me njëri-tjetrin kërkojnë dëshminë e Sali Berishës. Kjo natyrisht nuk është rastësi, por një përpjekje e koordinuar mes dy ortakëve me urdhër të Edi Ramës për të larguar vëmendjen nga krimet dhe trafiket ku janë përfshirë së bashku. T'i kërkojë Edi Ramës të luftojë krimin e organizuar është njësoj si t'i kërkojë të luftojë vetveten", shkruan Basha.

pasi ishte paraqitur jo sipas kriterëve ligjore. Ndërsa Kloteta Dibra, rivalja e Konit në garë deklaroi se me profesorin ka pasur marrëdhënie të mira, por për kërcënimin është informuar nga media. Në seancën e radhës do të thirren për të dëshmuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda ish-kryeministri Sali Berisha, ministria e Arsimit, Lindita Nikolla dhe dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Dhori Kule.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2,700,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 neto për personin autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë"**

Ofterta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 2 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Upgrade i sistemit të Regjistrimit të Kredive të Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur ndërkombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 30,000,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Upgrade i sistemit të Regjistrimit të Kredive të Bankës së Shqipërisë"**

Ofterta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 12 Dhjetor 2017, ora 9:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

"Në profilin tim postuan një status joreal, më hakeruan edhe llogarinë në "Facebook"

U kërcënua me jetë nga ish-kryeprokuroria, Ledian Halilaj kërkon urdhër mbrojtjeje

26-vjeçari: E vërteta ime me Rita Gjatin

Ina Allkanjari

Dytë ditë pas denoncimit publik të ish-kryeprokurores së Kukësit Rita Gjati, 26-vjeçari Ledian Halilaj ka kërkuar urdhër mbrojtjeje nga prokuroria. Kjo për faktin se përveç kërcënimeve të marra sipas tij nga kryeprokuroria Gjati për prerje koke, duarsh dhe këmbësh, atij i është hakeruar faqja në rrjetin social "Facebook". Gjithashtu, i riu pretendon se ka pasur ndërhyrje edhe në aparatën e tij celular. Kjo, pasi i janë fshirë thirrjet hyrëse dhe dalëse të kryera me kryeprokuroren. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Ledian Halilaj u shpreh se dje i është drejtuar Prokurorisë për Krime të Rënda në Tiranë për të kërkuar urdhër mbrojtjeje, ku ka biseduar me zv.drejtorin. Ndërkohë, ai pohoi se kërkesa e tij për urdhër mbrojtjeje i është deleguar prokurorisë së Lezhës, e cila një javë më parë ka nisur hetimet për kërcënimet e bëra ndaj tij nga ish-kryeprokuroria e Kukësit. Gjithashtu, Halilaj sqaroi dhe pse mendon se vjedhja e faqes së "Facebook"-ut të tij lidhet me kryeprokuroren Gjati.

Cila është arsyeja që kërkuar urdhër mbrojtjeje nga prokuroria?
Shumë ngjarje të ndodhura ditët e fundit më



Ledian Halilaj

bënë t'i drejtohesha prokurorisë për të kërkuar një urdhër mbrojtjeje. Përveç kërcënimit të marrë nga ish-kryeprokuroria Rita Gjati në 31 korrik të 2017, disa ditë më parë më hakeruan faqen time të "Facebook"-ut. Por kjo nuk mbaroi me kaq, pasi vura re që më kishin ndërhyrë edhe në aparatën tim celular, duke më fshirë thirrjet hyrëse dhe dalëse të kryera me ish-kryeprokuroren.

A u pranua kërkesa juaj?

Sot (dje) takova zv.drejtorin e Prokurorisë për Krime të Rënda në Tiranë për t'i kërkuar urdhrin e mbrojtjes, të cilin e falënderoj për suportin dhe mbështetjen që më ofroi. Ai më shpjegoi se urdhrin e

mbrojtjes në rastin tim e jep gjykata me kërkesë të prokurorit përgjegjës që po ndjek çështjen time. Për këtë arsye do i drejtohem prokurorit përgjegjës në Lezhë për të depozituar një kërkesë për mbrojtje.

Pse mendon se vjedhja e faqes suaj të "Facebook"-ut lidhet me ish-kryeprokuroren Rita Gjati?

Vjedhjen e faqes sime në "Facebook" e lidh me ish-kryeprokuroren, pasi disa ditë më parë, përpara se të më merrnin përfundimisht faqen pa pasur mundësi ta rimarr më, dikush postoi një shkrim në emrin tim. Ishte një postim joreal, ku i kërkoja falje prokurores Rita Gjati, pasi unë kam qenë i dehur kur kam bërë

hakeruesi ka lidhje me prokuroren në fjalë. Por besoj se është detyra e organeve kompetente për të hetuar rastin që parashtrrova.

Cilat janë provat materiale që dispononi dhe që dëshmojnë hakerimin e faqes e ndërhyrjen në aparatën tuaj celular?

Pavarësisht ndërhyrjes në aparatën tim celular, pas thirrjes unë i bëra 'screenshot' bisedës, ku verifikohet qartazi data, ora sa ka zgatur biseda dhe me cilin numër është kryer telefonata. Nëse do të verifikohen tabulatet telefonike të kryeprokurores, pasi telefonata ku jam kërcënuar ka qenë një thirrje dalëse nga aparati celular i Rita Gjati, atëherë çështja do të zbardhet. Gjithsesi, përta i përket hakerimit, kallëzimin penal po e ndjek ko-

denoncimin. Kjo gjë më s'oli dyshime të arsyeshme se

misariati i policisë së Kukësit. Sipas informacioneve të marra, policia e Kukësit ia ka depozituar rastin Drejtorisë së Përgjithshme në Tiranë, konkretisht Departamentit të Krimeve Kompjuterike.

Cila është thirrja juaj ndaj instancave përkatëse?

Për arsye përsheptimi të hetimit, kam njoftuar dhe azhurnuar për rastin në fjalë kryeprokuroren Adriatik Llalla, kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj. I kam lajmëruar nëpërmjet kontakteve zyrtare duke u shpjeguar situatën, por për zbardhjen e saj dhe verifikimin e kërcënimeve, u kërkoj hetuesve përgjegjës që të marrin akses nga kompania celulare për verifikimin e thirrjeve telefonike të ish-kryeprokurores në drejtim të numrit tim.

Feti Yzeiraj mori hak për vrasjen e gjyshit

Fier, vrasja e Shefo Durajt u zbulua nga telefoni i tij, arrestohet autori

Një vit pas masakrës së 57-vjeçarit Shefo Duraj, policia e Fierit ka arrestuar autorin e dyshuar të vrasjes, Feti Yzeiraj. Vënia në pranga e 41-vjeçarit u bë me kërkesë të prokurorisë, pasi ndaj tij kanxjerrë një urdhër ndalimi duke e akuzuar për "Vrasje me dashje". Ngjarja në fjalë është shënuar në muajin nëntor të vitit 2016, ku në vendin e quajtur "Bregu i Shkunjëzës", në Mallakastër u gjet e djegur kufoma e 57-vjeçarit. Dyshohet se Shefo Duraj është vvarë për motive hasmërie, pasi babai i tij, Llano Duraj ka vvarë rreth viteve 1968 gjyshin e autorit të krimit të rëndë, tashmë të prangosur. Po ashtu, hetuesit e çështjes kanë dyshime se Feti Yzeiraj e ka rrëmbyer fillimisht 57-vjeçarin, dhe më pas e ka çuar në pyll, ku e ka qëlluar me thikë dhe ka tentuar edhe të djegë trupin. Ek-



Shefo Duraj

NGJARJA

Më 29.11.2016, në vendin e quajtur "Bregu i Shkunjëzës" u gjet e djegur kufoma e shtetasit Shefo Duraj, për të cilin familjarët më datë 15.11.2016 kanë bërë kallëzim për humbjen e tij. Kufoma u konstatua se ishte e djegur, ndërsa nga hetimet u zbulua se 57-vjeçari ishte vvarë nga shtetasia Feti Yzeiraj.

spertët mjeko-ligjorë zbuluan shenja djegjeje të shkallës së parë të viktimit. Autori u zbulua për shkak se në dëshminë

që ka dhënë grupja e viktimës, ka rrëfyer se autori i vrasjes, Feti Yzeiraj e kishte pyetur bashkëshortin e saj se ku kalohet për në fshatin Arvanitas të Mallakastër dhe se ai ia kishte treguar rrugën. Sakaq, Prokuroria dhe Policia arritën të zbulojnë autorin e këtij krimi të rëndë, edhe për shkak se Yzeiraj kishte marrë telefonin e Shefo Durajt dhe e mbante atë në shtëpi, madje edhe e kishte regjistruar në emrin e tij.

Pikërisht telefoni i gjetur i viktimës i çoi të zbulonin gjurmë të tjera gishtash. Shefo Duraj, pasi mbylli turnin e tretë në Uzinën e Ballshit, telefonoi familjen dhe i tha se po shkonte te një mik në Skrapar për ngushëllim. Në këtë kohë dyshohet se Feti Yzeiraj e rrëmbëu 57-vjeçarin dhe e masakroi atë për vdekje.

Dhunoi e i vodhi 30 mijë lekë bashkëshortes, arrestohet 39-vjeçari

Një 39-vjeçar është arrestuar nga policia e kryeqytetit pasi akuzohet se dhunoi fizikisht bashkëshorten e tij dhe se nën kërcënimin e thikës i mori një sasi lekësh. Burime zyrtare nga policia bënë dje me dije se në pranga u vu shtetasia Varh Uku, i dënuar më parë për dhunë në familje. Arrestimi i tij u bë nga shërbimet e policisë të Komisarlatit Nr.3. Sipas policisë, ky shtetas në rrugën "Dritan Hoxha", për motive xhelozie, ka dhunuar fizikisht bashkëshorten, shtetasen E.U., 34 vjeçe, dhe nën kërcënimin e një thike i ka marrë shumën prej 3000 lekësh të reja. Në cilësinë e provës materiale uniformat blu sekuestruan një thikë, ndërsa 34-vjeçarja ka deklaruar se kjo nuk është hera e parë që ka rënë pre e dhunës. Ajo ka rrëfyer më tej, se nuk ka bërë denoncim më parë, për shkak të frikës që kishte pasur nga bashkëshorti.



39-vjeçari akuzohet për veprat penale "Dhunë në familje", "Vjedhje" dhe "Prdhim dhe mbajtje pa leje e armëve të ftohta".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 16.10.2017 në orën 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Iriša Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdue, Njësia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së palujtshme të llojit "Ara+Shëtitë Barimi" me sipërfaqe totale 2000 m² nga e cila truall 500 m² nga kjo ndërtesë 3 kateshe me sipërfaqe totale 544 m², e regjistruar në regjistrin hipotekor me volum 4, faqe 3, numer pasurie 34/44, në zonen kadastrale 1934, me adresë Hasan (Kruje).Cmimi në ankand të trete është në vlerën 6.552.000 (gjashtë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë.

Numri i aplikantëve në rritje, tarifat përcaktohen nga universiteti përkatës

'Hapat që duhet të ndiqni për të studiuar në Amerikë'

Aida Hudhri: Ja si të fitoni bursë

Voltiza Duro

Shtetet e Bashkuara kanë hapur aplikimet për të gjithë ata që duan të vazhdojnë studimet në një prej universiteteve amerikane. Në një njoftim të publikuar në faqen e saj zyrtare, Ambasada Amerikane jep orientimet për të gjithë të interesuarit, dhe rekomandon maturantët e studentët që të drejtohen në Qendrën Informative të Arsimit Amerikan në Shqipëri. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Aida Hudhri, këshilluese edukative në këtë qendër, tregon se numri i studentëve shqiptarë që studiojnë në Amerikë është në rritje nga viti në vit. Gjithashtu, ajo vendos theksin mbi hapat që duhet të ndjekin aplikantët për të fituar të drejtën e studimit në një universitet amerikan. Kjo qendër, sipas këshillueses, ofron informacione falas për të gjithë të interesuarit dhe i orienton mbi përzgjedhjen e institucionit më të përshtatshëm. Madje, instruktorët i ndihmojnë aplikantët edhe me formulimin e kërkesave për mbështetje financiare.



Aida Hudhri, këshilluese edukative në Qendrën Informative të Arsimit Amerikan në Shqipëri

atshëm. Madje, instruktorët i ndihmojnë aplikantët edhe me formulimin e kërkesave për mbështetje financiare.

Kush mund të aplikojë për të studiuar në SHBA?

Çdo vit, një numër i konsiderueshëm maturantësh dhe studentësh nga Sh-

HAPAT PËR TË APLIKUAR PËR STUDIME NË SHBA

- Shqyrto alternativën më të mirë për arsimim;
- Përfundo dokumentacionin për aplikim;
- Financo studimet, duke aplikuar për bursë;
- Apliko për vizë studentit;
- Përgatit udhëtimin për në USA.

qipëria kërkojnë të ndjekin studimet Bachelor dhe Master në USA. Në këto universitete mund të aplikojë çdo i interesuar që përmbush kriteret e pranimit të vendosura nga vetë institucioni i arsimit të lartë ku do të vazhdojë studimet, si dhe theksoj se nuk ka një kriter moshe të përcaktuar për të aplikuar.

Cilat janë kriteret e vendosura?

paraprakisht kriteret e pranimit për fusha të ndryshme studimi.

A është i përcaktuar numri për studentët që pranohen brenda një viti në universitetet e SHBA?

Jo, nuk ka një numër të caktuar studentësh nga Shqipëria që pranohen brenda një viti në universitetet e kolegjet amerikane. Por vlen të nënvizoj faktin që, numri i studentëve shqiptarë që studiojnë në Amerikë është në rritje çdo vit.

Për cilat degë mund të aplikojnë maturantët apo studentët?

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë në të gjitha degët. Ndërkohë, drejtësia dhe mjekësia janë dy nga degët që kanë një rrugëtim ndryshe nga Shqipëria. Qendra jonë është e pajisur me një bibliotekë të pasur me libra dhe CD, sipas fushave më parësore të arsimimit. Aktualisht, Qendra Informative e Arsimit Amerikan në Shqipëri, ka rreth 300 libra të fushave të ndryshme, si në: Arkitekturë, Biologji, Mjekësi, Farmaci, Inxhinieri, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Drejtësi, Ekonomi, Telekomunikim, Psikologji, Punë Sociale, Sport etj. që u vijnë në ndihmë aplikantëve.

Në momentin që një student fiton të drejtën për të studiuar në një universitet në Amerikë, a ka tarifa studimi?

Normalisht që ka tarifa studimi, që përfshijnë takson e shkollës dhe koston e jetesës. Këto tarifa përcaktohen nga universiteti apo kolegji përkatës.

A ofrohen bursa studimi?

Po! Shumë universitete ofrojnë bursa të pjesshme apo të plota. Shumë studentë shqiptarë kanë arritur të fitojnë bursa në Amerikë. Instruktorët pranë qendrës sonë i informojnë aplikantët mbi mbështetjen financiare apo mundësitë e bursimit. Madje i ndihmojmë edhe në formulimin e hartimit e

kërkesave për mbështetje financiare. Faqja zyrtare në internet përjavësohet me mundësi të ndryshme bursash studimi si dhe njoftimesh të tjera të rëndësishme.

Cili është misioni i qendrës suaj?

Tashmë, të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të studiojnë në SHBA, kanë në dispozicion të tyre një Qendër Informative të Arsimit Amerikan, ku mund të marrin informacione pa pagesë. Këshilluesit pranë qendrës informative kanë përvojë dhe kualifikimin e duhur për të ndihmuar me arsimin e lartë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Biblioteka e qendrës disponon edhe libra përgatitorë për testimin e gjuhës angleze, TOEFL, PEARSON si dhe libra për testimin e njohurive në ACT, GRE, LSAT, SAT, GMAT, të shoqëruar me CD-të përkatëse. Ne u mundësojmë të interesuarve edhe orientim për testet, e informim mbi jetën sociale dhe kulturore në USA.

Cilat janë hapat që studentët duhet të ndjekin për të aplikuar?

Instruktorët tanë i orientojnë dhe qartësojnë aplikantët, që të ndjekin në mënyrë vijuese hapat e duhur, të cilët do të përmbledheshin në 5 të tillë. Së pari, të interesuarit duhet të shqyrtojnë alternativën më të mirë për arsimim, e më tej të përfundojnë dokumentacionin për aplikim. Pas kësaj aplikantët duhet të financojnë studimet duke aplikuar për bursë, e më tej duke aplikuar për vizë studentit. Pas plotësimit të hapave të pikave të mësipërme, studentët duhet të përgatisin udhëtimin për në USA. Instruktorët pranë Qendrës i ndihmojnë të interesuarit edhe në formulimin dhe hartimin e: Curriculum Vitae, letres së motivimit, letrave të rekomandimit, eseve.

Çfarë është EducationUSA?

EducationUSA është një rrjet prej 500 qendrash informative në të gjithë botën, ku miliona studentë të vendeve të ndryshme marrin informacion të detajuar dhe të përditësuar për mënyrën e aplikimit dhe shkollimit në kolegjet dhe universitetet amerikane. Ky rrjet i qendrës informative gëzon mbështetjen e plotë të Zyrës për Edukim dhe Çështjet Kulturore të Departamentit të Shtetit Amerikan. EducationUSA Albania financohet nga Ambasada Amerikane në Shqipëri.



The European Union Delegation to Albania is looking for a

SECRETARY

Functions include general administrative and secretarial support to the Finance, Contracts and Audits section

For complete information and application, please refer to:

https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en

"Jobs & Funds" > "Jobs, Internships" > "Job offers"

We offer:

- Multicultural working environment
- Competitive salary
- Benefits by law

For all questions please refer to https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en

("Jobs & Funds") or contact us via DELEGATION-ALBANIA-JOBS@eeas.europa.eu

Deadline for applications: 20/10/2017

Vendimi unifikues, kjo kategori duhet të kthejë mbrapsht 2-37 milionë lekë të vjetra

Gjykata Kushtetuese nuk bën publik vendimin, në "ankth" mijëra ushtarakë

Avokati: Nuk kam informacion mbi seancën

Voltiza Duro

Në Gjykatën Kushtetuese u zhvillua dje seanca në lidhje me fatin e pensioneve të mijëra ushtarakëve në lirim në të gjithë vendin, por ky vendim ende nuk është bërë publik. Kërkesë-padia e ushtarakëve kërkon shfuqizimin e vendimit unifikues të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë. Ky i fundit konsiston në rrillogaritjen e pensioneve të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, çka do të sjellë uljen e pensioneve. Avokati i shoqatave të ushtarakëve, Bashkim Asllanaj tregon për "Gazeta Shqiptare" se deri më tani nuk ka asnjë informacion mbi këtë çështje. "Në këtë seancë unë nuk kam qenë i pranishëm, duke zbatuar urdhrin e datës 22 shtator të Gjykatës Kushtetuese, e cila më njoftoi se do të shqyrtohet kërkesë-padia për shfuqizimin e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, por pa praninë e palëve. Deri më tani nuk kam dijeni sesi ka vijuar seanca, pasi kjo gjykatë është treguar shumë hermetike në këtë pjesë", thotë avokati i ushtarakëve.

VENDIMI

"Në këtë seancë unë nuk kam qenë i pranishëm, duke zbatuar urdhrin e datës 22 shtator të Gjykatës Kushtetuese, e cila më njoftoi se do të shqyrtohet kërkesë-padia për shfuqizimin e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, por pa praninë e palëve. Deri më tani nuk kam dijeni sesi ka vijuar seanca, pasi kjo gjykatë është treguar shumë hermetike në këtë pjesë", thotë avokati i ushtarakëve.



KËRKESAT

- Shfuqizim total të aktit normativ numër 5, që konsiston në uljen e vierës së pensioneve, nga 1800 lekë në vetëm 12000 lekë të reja.
- Shfuqizimin e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, që ndikon në uljen e pensioneve.
- Nxjerrja e VKM-së për transferimin e shërbimeve të Spitalit Ushtarak, për ceremonialin mortar të ushtarakëve që ndahen nga jeta.
- Nxjerrja e urdhrin të ministrit të Mbrojtjes për t'u dhënë të drejtë të gjithë ushtarakëve të vendit, në rezervë, në lirim a në pension që të frekuentojnë shtëpitë e pushimit të ushtarakëve.
- Ushtaraku të marrë pjesë në të gjitha ceremonitë festive apo përkujtimore

Kryetari i shoqatës, Konduri: Jemi në pritje të një përgjigjeje



Thoma Konduri

Kryetari i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, Thoma Konduri tregon për "Gazeta Shqiptare" se mijëra ushtarakë janë në ankth mbi vendimin që ka marrë Gjykata Kushtetuese ditën e djeshme. "Nuk kemi asnjë informacion

sesi ka shkuar fati ynë në lidhje me pensionet. Jemi në pritje të një përgjigjeje nga Gjykata Kushtetuese. Shpresojmë që të na jetë dhënë e drejta që na takon dhe të jetë vendosur shfuqizimi i vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kër-

komjë të vihet në vend dinjiteti ynë", - thotë Konduri. Sipas tij, ushtarakët në lirim nëse nuk marrin zgjidhje, do ta dërgojnë çështjen në Gjykatën e Strasburgut. Kryetari i SHKURSH-së kërkon edhe njëherë nga shteti shqiptar zbatimin e statusit të ushtarakut.

KËRKESAT E USHTARAKËVE

Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë, Shoqata e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë si dhe Shoqata e Organizatës së

punonjëse të Policisë së Shtetit në Lirim kanë kundërshtuar fuqishëm vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë. Sipas Bashkim Asllanajt, këto pensione do të përllogariten sipas skemës: 50% e pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi 12 vjet për gratë dhe 15 vjet për burrat, masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese me kushtin antikushetues, që masa e përgjithshme e pensionit të parakohshëm nuk mund të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi. Avokati i ushtarakëve në lirim thotë se vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë është antikushetues dhe antiushtarak, pasi bie në kundërshtim me Statutin e Ushtarakut.

akëve sërish nuk ka qenë i pranishëm, pasi nuk lejohej prania e palëve. Gjykata Kushtetuese ka bërë me dije avokatin Asllanaj se vendimi do të merret mbi bazën e akteve që shoqatat kanë depozi-

tuar në këtë gjykatë. Në bazë të vendimit unifikues nga gjykata, pas përllogaritjes së pensioneve, ushtarakët detyrohen të kthejnë mbrapsht vlerën që varion nga 2 milionë lekë deri në 37 milionë

lekë të vjetër. Mbi 20 mijë ushtarakë nga i gjithë vendi prej vitesh po përballen me dyert e gjykatave për zbatimin e statusit të ushtarakut dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

400 të rinj, pjesë e nismës

"Një ditë në Bashkinë e Tiranës"

Rreth 400 të rinj, gjimnazistë dhe studentë, janë bërë pjesë e nismës së Bashkisë së Tiranës për të ndjekur një ditë nga puna e saj e përditshme. Ata janë pritur në një takim nga kryebashkiaku Erion Veliaj, i cili u kërkoi që të shfrytëzojnë këtë mundësi për t'u njohur me punën që bën çdo drejtori në Bashkinë e Tiranës, ndërsa i ka ftuar që në fund të kësaj eksperiencë të ofrojnë idetë e tyre për çka duhet të ndryshojë në funksionimin e administratës dhe të jetës së qytetit. "Më vjen mirë që e kemi nisur këtë traditë fantastike, ku një ditë në muaj ftojme të rinjtë që të bëhen pjesë e stafit të bashkisë", tha kryebashkiaku. Ai evidentoi vullnetarizimin, si një nga fushat ku të rinjtë mund të japin kontributin e tyre. Ndaj, shtoi se një mundësi e mirë për të dhënë kontribut është Maratona e Tiranës, që zhvillohet të dielën më 15 tetor. Për muajin tetor do të jenë 120 të rinj, të cilët do të kalojnë ditën me një nga drejtorët e Bashkisë Tiranë sipas përzgjedhjes së tyre në aplikim.



Manastirliu: Nuk do të ketë më sorollatje

Nis puna për lehtësimin e procedurave të KEMP-it për personat me aftësi të kufizuar



Ministria e Shëndetësisë ka nisur punën për lehtësimin e procedurave të KEMP-it, nga e cila do të përfitojnë rreth 130 mijë persona me aftësi të kufizuar. Kjo është bërë me dije nga Ogerta Manastirliu, ministere e Shëndetësisë, gjatë takimit me përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuar dhe nevoja të veçantë. Ajo dëgjoi kërkesat e kësaj kategorie për përmirësimin e shërbimeve sociale shëndetësore. Një nga shqetësimet

e ngritura nga përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuar ishte vështirësia që hasin në marrjen e shërbimeve në nivel lokal. Por, Manastirliu u siguroi se do të integro-

hen më mirë shërbimet social-shëndetësore dhe do t'u shërbehet më shpejt qytetarëve. "Kemi nisur punën për lehtësimin e procedurave të KEMP-it për personat me af-

tësi të kufizuar. Nuk do të ketë më sorollatje nga njëri komision në tjetrin për vërtetimin e aftësisë së kufizuar, por po vlerësojmë heqjen e disa hallkave, për t'ua lehtësuar kalvarin e mundimshëm qytetarëve", u shpreh ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Përfaqësuesit e shoqatës së Invalidëve të Punës, në emër të 75 mijë invalidëve të punës shprehën mirënjohje për vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të nisur punën për lehtësimin e procedurave të KEMP-it.

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 11 Tetor 2017 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Ilir Meta në stadium, kush e shoqëroi presidentin...
- "Unë jam Fatos Nano", çfarë ndodhi mes tij dhe gardistit
- E veshur sportive, si pozon Bregu në atelienë e artit
- Bashkë Ndoka dhe Peleshi: Na lidh një miqësi ndër vite

Klea Huta më në fund pranon lidhjen me Elgid Dodën, çifti del publikisht



Marina Fara nuk di të ndalet, ja fotot "hot"



Rrëfëhet Lumturi Ratkoceri: Rrugëtimi im në politikë. Ka gra që kanë bërë karrierë duke thënë veç 'po'



Vjehrra e moderatores: Unë dhe Floriana Garo si dy mikështa, ja marrëdhënia ime me të

Kryetarja e ALK: Po pres me padurim të bëhem gjyshe

Rrëfëhet Lumturi Ratkoceri: Rrugëtimi im në politikë. Ka gra që kanë bërë karrierë duke thënë veç 'po'

Vjehrra e moderatores: Unë dhe Floriana Garo si dy mikeshë, ja marrëdhënia ime me të

Kryetarja e AK: Po pres me padurim të bëhem gjyshe

Enida Himaj

Kryetarja e Aleancës Kuqezi u shndërrua në kryefjalën e mediave, teksa u zbulua se ishte vjehrra e moderatores Floriana Garo. Lumturi Ratkoceri, vjen në një rrëfim për suplementin "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare" për të na zbuluar detaje nga rrugëtimi i saj në politikë dhe hapat që e çuan në krye të Aleancës Kuqezi, gjithashtu për të treguar se sa ka ndikuar angazhimi politik në largimin nga familja dhe për marrëdhënien që ka me nusen e djalit. Angazhimi në politikë e ka bërë që të mos jetë gjatë pranë familjes, megjithatë ajo pohon se ka ardhur koha që t'i kthejë në shërbim të vendit aftësitë e saj. Djemtë janë mbështetja më e madhe që ka, e kur bëhet fjalë për këta të fundit, Ratkoceri na flet edhe për raportin e saj me nusen e Enisit, Florianën. Ajo na zbulon se çifti është njohur në një udhëtim në Itali. Për Florianën thotë se, nuk e ka parë ndonjëherë raportin e tyre me syrin e vjehrrës dhe të nuses. Ato njihen prej një viti dhe marrëdhënia e tyre është e dy mikeshave të mira që e vlerësojnë dhe e respektojnë shumë njëra-tjetrën. Së fundmi, Lumturia thotë se po e pret me padurim momentin kur do të bëhet gjyshe.

Si ka nisur rrugëtimi juaj në politikë?

Rrugëtimi im në politikë ka filluar në vitin 2004, kur u emërova drejtoreshë e "Universitetit Shqiptar të Gjenevës". Në kushtet e një fushate denigruese kundër nesh, nga ana e partisë ultra të djathtë zvicerane UDC, dhe një mungese të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave tona nga ana e ambasadës shqiptare, si dhe të mungesës së përfaqësimit institucional të komunitetit shqiptar të Kosovës, unë u angazhova fërdësisht, duke u bërë zëri i komunitetit.

Përse zgjodhët Aleancën Kuqezi?

Aleancën Kuqezi e zgjodha për faktin se ishte dhe është e vetmja parti që ka një vizion të qartë si duhet të bëhet Shqipëria dhe mënyrat për t'ia arritur. AK është e para parti politike që kërkoi reformën në sistemin gjyqësor dhe vendosjen e shtetit ligjor. Në 2012-



Lumturi Ratkoceri

ën, ishte AK që ngriti zërin dhe kërkoi që funksionarët e lartë të shtetit, duke filluar nga kryeministri, të mbanin përgjegjësi penale për veprimet e tyre. Sot, reforma në drejtësi është në gojë dhe të gjitha forcat politike, dhe ne anëtarët dhe anëtarët e AK ndihemi krenarë për përmbytjen e këtij misioni. Principi i reciprocitetit në politikën e jashtme është një tjetër ide e programit të AK dhe që po bën rrugën e saj. Mbi të gjitha bashkimi i kombit, si e drejta më legjitime dhe absolute e popullit shqiptar. Kjo është rruga e vetme që kombi ynë të ecë drejt prosperi-

tetit.

Duket se kjo forcë identifikohet me Kreshnik Spahiun; sa të vështirë do ta kemi ta ndryshoni këtë gjë?

AK është identifikuar me Kreshnik Spahiun sepse ai ishte themeluesi dhe ideatori i filozofisë së AK. Prioriteti im është të vazhdoj luftën pa kompromis - që e kemi filluar së bashku që në 2011-ën - kundër mafies shtetërore, që e ka kapur për fyti vendin tonë dhe po e mbyti.

A keni marrë ftesë nga partitë e tjera?

Ne bashkëpunojmë me të gjitha partitë joparlamentare për kr-

Angazhimi

Sigurisht, angazhimi im në politikë më ka bërë që të mos jem pranë familjes aq sa do të dëshiroja. Por mendoj që ka ardhur koha që unë të kthehem dhe, ashtu si shumë bashkatdhetarë të tjerë, të vë në shërbim të vendit tim aftësitë e mia. Dhe djemtë e mi janë mbështetja më e madhe në angazhimin që kam marrë.

ijimin e një fronti unik kundër diktaturës së krimit që po instalohet me shpejtësi. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, erdhi dhe deklarata për qëndrimin e unifikuar për reformën zgjedhore.

Si e shikoni klasën politike në vend?

Për mendimin tim, të flasësh për "klasë politike" në Shqipëri do të thotë t'u bësh një shërbim shumë të madh. Termi më i saktë do të ishte "banda politike". Sigurisht që, vendi ynë ka politikanë të ndershëm dhe me integritet, por fatkeqësisht zëri i tyre nuk dëgjohej.

Nëse do të ishte zëri juaj në

parlament, për çfarë do të flisnit më së shumti?

Nëse ne do të ishim në parlament, do të ngrinin zërin kundër kapjes së organeve të vetingut nga mazhoranca, për reformën zgjedhore, nxjerrjen e ligjit për koncesionet abuzive, rrëzimin e çdo varianti të aprovimit të ligjit të plehrave. Këto janë disa nga prioritetet.

Sa paragjykohe femrat në politikën shqiptare?

Megjithëse ne mbajmë një vend nderi në krahasim me vendet e tjera për sa u përket grave të shkolluara dhe të zonja, kjo nuk reflektohet aspak në jetën politike dhe ekonomike shqiptare. Të jesh politikanë te ne nuk është e lehtë. Duhet të kesh shumë kurajë dhe vendosmëri që të përballosh luftën e egër politike dhe presionin. Ka dy lloj grash në politikën shqiptare; ato që janë profesioniste të zonja dhe me integritet, dhe të "urtat", që i kanë ngjitur shkallët e karrierës duke thënë vetëm "po". Ashtu si një pjesë e madhe e burrave politikane shqiptarë. Por një gjë është e sigurt: gratë janë më të përgjegjshme dhe më pak të korruptuara se burrat në politikë.





Unë dhe Floriana as që e kemi parë ndonjëherë raportin tonë me syrin e vjehrrës dhe nuses. Ne njihemi prej një viti dhe marrëdhënia jonë është e dy mikeshave të mira që e vlerësojnë dhe e respektojnë shumë njëra-tjetrën. **Pres me padurim momentin kur do të bëhem gjyshe. Është ëndrra e çdo nëne. Por vendimi i takon çiftit, dhe unë e respektoj këtë**



Sa ju ka larguar nga familja angazhimi në politikë?

Sigurisht, angazhimi im në politikë më ka bërë që të mos jem pranë familjes aq sa do të dëshiroja. Por mendoj që ka ardhur koha që unë të kthehem dhe, ashtu si shumë bashkatdhetarë të tjerë, të vë në shërbim të vendit tim aftësitë e mia. Dhe djemtë e mi janë mbështetja më e madhe në angazhimin që kam marrë.

Kohë e fundit jeni përfolur në media edhe si vjehrra e Floriana Garos; nga është njohur djali juaj me moderatoren simpatike?

Enisi dhe Floriana janë njohur në një udhëtim në Itali.

Si është Lumturia si vjehrrë? Më shumë jeni mikeshja, apo respektoni raportin klasik nuse-vjehrrë?

Unë dhe Floriana as që e kemi parë ndonjëherë raportin tonë me syrin e vjehrrës dhe nuses. Ne njihemi prej një viti dhe marrëdhënia jonë është e dy mikeshave të mira që e vlerësojnë dhe e respektojnë shumë njëra-tjetrën.

A i ke kërkuar çiftit të ri të të bëjnë gjyshe?

Sigurisht që e pres me padurim momentin kur do të bëhem gjyshe. Është ëndrra e çdo nëne. Por vendimi i takon çiftit, dhe unë e respektoj këtë.

KLEA HUTA më në fund pranon lidhjen me ELGID DODËN, çifti del publikisht

Pas shumë zhurmave dhe thashethemeve lart e poshtë, ku flitej për lidhjen mes bukuroshes Klea Huta dhe këngëtarit Elgid Doda, më në fund ajo vendosi ta pranojë. Edhe pse, jo më larg se dje, ajo ishte e ftuar në emisionin "Rudina", dhe e pyetur nëse ishte e lidhur apo kishin diçka me këngëtarin Doda ajo tha që ishin vetëm miq dhe asgjë më tepër. Ja që, me sa duket, ka ndryshuar mendje. Kjo vihet re në profilin e saj në "Instagram", ku Klea ka postuar një foto të saj me Elgidin, shumë romantike, pa asnjë nënshkrim në të. Gjithsesi, fotoja flet shumë, dhe kishte ardhur koha që ta pranonte një lidhje kaq shumë të përfolur mes tyre. Duhet pranuar që janë një çift vërtet i bukur. Ne urojmë që të zgjasë sa më shumë dashuria mes tyre!



Ajo ka publikuar në rrjetet sociale disa foto në të cilat shfaqet në shtrat e mbuluar vetëm me një çarçaf. Nuk dihet përse Marina është duke realizuar foto kaq provokuese, por ato nuk kanë kaluar pa komente dhe pa vëmendjen e ndjekësve. Ditë më parë, bukuroshja ka qenë sërish në vëmendje, pasi u komentua për një lidhje të supozuar me Olsin e "BB9", thashethem që ajo e hodhi poshtë menjëherë. Disa muaj më parë, Fara dhe biznesmeni nga Shkodra Edi Ismaili u lidhën në fejesë. Por, ashtu siç ndodhi në mënyrë të beftë, ashtu edhe u ndanë. Marina është vajza e vetme e këngëtares Eli Fara.

Marina Fara nuk di të ndalet, JA FOTOT "HOT"

BULEVARDI

Na merrni seriozis!..!

POLITIK

Ilir Meta në stadium, kush e shoqëroi presidentin...

Presidenti i vendit, Ilir Meta ishte i pranishëm në stadiumin "Loro Boriçi" për të ndjekur sfidën mes Kombëtares shqiptare dhe asaj italiane. Përveç fotos me ish-kapitenin Lorik Cana, i cili i dha zyrtarisht fund futbollit të luajtur në ndeshjen me Italinë, u vu re sërisht mungesa e bashkëshortes së tij, Monika Kryemadhi në stadium. Kreu i shtetit shoqërohej nga vajza e tij, Era si dhe Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, me të cilin edhe janë fotografuar. Ndërsa bashkëshortja e tij, Monika Kryemadhi, që tashmë ka marrë drejtimin e LSI-së, ka vijuar të mbajë premtimin, ashtu si në evente e ceremoni të tjera, për të mos u shfaqur krahas bashkëshortit president.



"Unë jam Fatos Nano", çfarë ndodhi mes tij dhe gardistit

Në teatrin "Migjeni", gjatë ceremonisë ku janë ekspozuar 4 kupat e botës, kanë qenë të pranishëm mjaft personazhe të njohur nga bota e sportit, por nuk mungonin figura të rëndësishme të politikës aktive dhe të tjerë të tërhequr. Një nga figurat që spikati me prezencën e tij në "Loro Boriçi", ishte ish-kryeministri Fatos Nano. Nano, pas ceremonisë në teatrin "Migjeni", u nis drejt stadiumit "Loro Boriçi" me makinën e tij super luksoze të llojit "Maserati". Në momentin kur Nano ka mbërritur përballë stadiumit, ka tentuar të parkojë, por është ndaluar nga punonjësit e Gardës. Në këtë moment ish-kryeministri Nano i është drejtuar gardistit duke i thënë: "Unë jam Fatos Nano". Ndërsa ky i fundit i është përgjigjur: "Unë të njoh, por nuk lejohet".

E veshur sportive, si pozon Bregu në atelienë e artit

E veshur e gjithë me të zeza dhe sportive, e qeshur, e ulur në një karrige përballë një pikturë... Kështu shfaqet ish-deputetja e PD-së, Majlinda Bregu, në një foto të postuar në rrjetet sociale. "Se shoqat e mia kanë bërë atelienë e re", shkruan Bregu, në postimin shoqëruar të kësaj fotografie.



Bashkë Ndoka dhe Peleshi: Na lidh një miqësi ndër vite

Pavarësisht krahëve të kundërt politikë, politikanët dhe më shumë deputetë shqiptarë e kanë treguar se kjo gjë nuk i pengon për të ruajtur miqësinë me kolegët kundërshtarë. Njëri nga ata është dhe kreu i PDK-së, Nard Ndoka, i zgjedhur deputet në listat e PD-së, i cili ka bërë të ditur se ruan miqësi me ministrin e Bujqësisë Niko Peleshi. Nard Ndoka ka shpërndarë një foto në "Facebook", së bashku me ministrin Peleshi dhe deputetin Ilirjan Pandavini, dhe shkruan: "Përtej bindjeve politike, me këta korçarët na lidh një miqësi ndër vite".

Policia: Ngjarja për konkurrencë, ose nga banorë të zonës që kundërshtojnë ndërtimin

Masakrohen me qytë automatiku dhe mjete të forta 5 punonjës të HEC-it të Valikardhës

Drejtori Lulzim Laloshi: Në sulm morën pjesë 20 persona të maskuar, kemi konflikt të vjetër me Bashkinë e Bulqizës

Enver Doçi

BULQIZË

Terror në Bulqizë. Një grup prej 20 personash të armatosur, disa prej të cilëve të maskuar kanë masakruar 5 punonjës të HEC-it të Valikardhës. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ngjarja e rëndë ka ndodhur pasditen e djeshme. Mësohet se agresorët kanë goditur me qytë automatiku dhe mjete të forta punonjësit e HEC-it dhe për pasojë këta të fundit kanë përfunduar me plagë të rënda në spitalin e Bulqizës. Menjëherë pas sinjalizimit për sulmin mbi punonjësit e HEC-it, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. Sipas bluve, persona ende të paidentifikuar kanë ushtruar dhunë mbi pesë punonjës të centralit të Krashtës, ku dy prej tyre dhe konkretisht G.B. rreth 50 vjeç, banues në Elbasan dhe shtetasin K.R. rreth 45 vjeç, banues në Shkupenë kanë mbetur të plagosur.

Ndërsa, tre të tjerët nuk kanë pësuar asnjë dëmtim. Pas kryerjes së hetimeve paraprake, dyshohet se ngjarja mund të ketë marrë shkas për motive konkurrence, pasi në zonën e Martaneshit numërohen disa HEC-e. Por, nuk përjashtohet mundësia që pjesëtarë të këtij sulmi të jenë edhe banorë të zonës, të cilët kundërshtojnë ndërtimin e HEC-it. Ndërkohë, në lidhje me këtë ngjarje ka reaguar edhe drejtori i HEC-it të Valikardhës, Lulzim Laloshi. Ndryshe nga policia, e cila deklaroi se ngjarja ka ndodhur në HEC-in e Krashtës, Laloshi pohoi se sulmi ka ndodhur të vendi i quajtur Liqeni i Bardhë. Ndërkohë, ai deklaroi për "Gazeta Shqiptare" se kanë një konflikt të vjetër me Bashkinë e Bulqizës, e cila do të bllokojë punimet. Sipas Lulzimit Laloshës, vlera në total e HEC-it të Valikardhës është 30 milionë euro, ndërsa deri tani janë investuar 24 milionë euro.

NGJARJA

Rreth orës 16:00 të ditës së djeshme, pesë punonjës të HEC-it të Valikardhës ishin



Policia e Bulqizës


duke punuar tek Liqeni i Bardhë në Tërnovë për hapjen e kanaleve ujëmbledhës, kur kanë rënë pre e një sulmi masiv. Sipas drejtorit të përgjithshëm të këtij HEC-i, Lulzim Laloshi, një grup i madh personash kanë sulmuar punonjësit. "Pjesë e sulmit kanë qenë 20 persona. Disa prej tyre kanë qenë në pyll dhe kanë qëlluar me armë në ajër. Ndërsa disa të tjerë (të maskuar) kanë sulmuar fizikisht 5 punonjësit, duke i goditur me mjete të forta dhe me

qytë automatiku", tha ai. Si pasojë e dhunës, 5 punonjësit kanë përfunduar në spital. 3 prej tyre kanë marrë ndihmë mjekësore dhe më pas janë larguar nga spitali. Ndërsa, 2 të tjerë ndodhen në gjendje të rëndësishme mjekësore. Mjekët e spitalit të Bulqizës pohuan se dy punonjësit që janë të shtruar mund të dërgohen për ndihmë më të specializuar në Tiranë.

HETIMET

Sulmi ndaj punonjësve të TEC-it të Valikardhës ka alarmuar policinë e Bul-

qizës, e cila po heton intensivisht për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe identifikimin e vënien në pranga të autorëve të krimit. Paraprakisht dyshohet se ngjarja mund të ketë ndodhur për arsye konkurrence. Burime konfidenciale thanë për "GSH" se 5 punonjësit e TEC të Valikardhës mund të jenë sulmuar nga punonjës të HEC-ve të tjera, të cilët janë shtyrë nga drejtuesit e tyre. Por, nuk përjashtohet mundësia që agresorët të kenë qenë banorë të zonës, të cilët kundërshtojnë prej kohësh ndërtimin e HEC-it në fjalë. Nga ana tjetër, drejtori i përgjithshëm i HEC-it të Valikardhës, Lulzim Laloshi u shpreh se, "nuk besoj se ngjarja ka si motiv konkurrencë. Në kemi një konflikt të vjetër me Bashkinë e Bulqizës, që do të bllokojë punimet. Ajo që ndodhi ishte ngjarje e rëndë dhe duhet të zbardhet shumë shpejt nga organet kompetente. Në kemi taksapagues të rregullt në shtet dhe jemi në rregull me dokumentacionin".



Kapet pas 4 muajsh arrati i kërkuari për drogë

DURRËS - Një 34-vjeçar është arrestuar në Durrës pas 4 muajsh arrati për posedim droge dhe armësh. Në pranga është vënë Emilian Gjepali, banues në Shijak, të cilit më 16 qershor 2017 iu sekuestruan drogë, municione luftare dhe armë. Mësuar se Gjepali kishte fshëhur 150 gr kokainë në shtëpinë e të vëllait. Burime pranë policisë deklaruan se kanë dyshime se 34-vjeçari dyshohet të jetë i përfshirë në veprimtarinë kriminale të dokumentuar me prova ligjore nga ana e specialistëve për narkotikët. Emilian Gjepali akuzohet për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftare dhe municionit" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

Bënte mbishkrime naziste, bie në pranga 47-vjeçari

SARANDE - Policia e Sarandës ka vënë në pranga një 47-vjeçar nga fshati Pece i Delvinës, pasi kërkohet prej 5 ditësh. I arrestuari është Dhimo Korini. Fillimisht ai ishte në kërkim nga Policia e Gjirokastrës, pasi në 5 tetor, në fshatin Dervican, shkroi me sprajt simbole naziste në dy kolonat e pallatit të kulturës dhe në lapidarin e fshatit. Ai nuk iu bind policisë dhe arriti të largohet me mjetin e tij tip "Suzuki". Por, mania e 47-vjeçarit nuk mbaroi me kaq. Të hënën, nga fshati Pece i Delvinës, banorët denoncuan në polici se në portat e shtëpiëve të tyre, Dhimo Korini kishte shkruar simbole naziste. Menjëherë blutë e Sarandës janë nisur në fshatin Pece për të ndaluar 47-vjeçarin. Ai është pikasur në drejtimin e mjetit tip "Suzuki", por nuk i është bindur thirrjes së policisë duke shtuar shpejtësinë, megjithatë është ndaluar disa minuta më vonë. Brenda në mënjë policia ka gjetur dhe sekuestruar edhe 55 gr kanabis si dhe një thikë. Dhimo Korini akuzohet për "Nxjitja e urrejtjes ose e grindjeve ndërmjet kombësive, racës dhe feve", si dhe disa vepra të tjera penale.

81-vjeçari: Na paratë, gruas ia hoqe varësen nga qafa

Grabiten me armë, bashkëshortët e moshuar: Tre autorët na kërcënuan se do të na vrisnin

VLORË - Dy të moshuar nga qyteti i Vlorës janë dhunuar e grabitur mbrëmjen e së hënës nga tre persona të armatosur. Mësohet se agresorët kanë mësyre banesën e bashkëshortëve Resmi e Sanije Osmenaj, përkatësisht 81 vjeç dhe 75 vjeç, e cila ndodhet në zonën e plazhit të vjetër, në lagjen "1 Maji" të qytetit bregdetar. Nën kërcënimin e armëve, ata i kanë marrë çiftit një sasi parash dhe disa bizhuteri. Të tronditur, bashkëshortët kanë bërë denonim në polici. Ata kanë deklaruar se autorët i kanë kërcënuar se në rast se do të lajmëronin policinë, do t'i vrisnin. "I ranë ziles. Ne hapëm derën dhe pamë tre persona të armatosur me automatik. Këtë e shtynë, e përsheshën aty. E zinin për fyti. U ngrita ashtu si



Resmi e Sanije Osmenaj

isha, më dhanë një të shtyrë, rashë edhe unë. Këmbë e duar vajta në krevat. Atëherë e ngritën këtë dhe e përplasën aty. Kjo (gruaja) ulërinte. Na thoshin mos lëvizni se do ju vrasim. Pastaj na kërkuan paratë. Unë u tregova i singërtë, u thashë që kisha në portofol. U thashë ato janë lekët e pensionit, ne nuk kemi para. Pastaj shkuan andej nga dollapi i kësaj. Gjetën edhe ca lekë andej. Ne e dimë çkemi hequr. Dy vetë erdhën brenda, një i gjatë, i hollë, ndërsa një i shkurtër,

pak ezmer. Panë foton e djalit, ndërsa gruaja u tha që na e kanë vrrarë. Ata thanë betohuni për djalin që nuk do njoftoni policinë. Imorën varësen dhe unazën gruas, por unazën ia kthyen, pasi ajo iu lut. Ai i gjati, se ai tjetri nuk donte. Menjëherë ne thirrëm policinë. Edhe erdhi vetë drejtori, nëndrejtori, shefi i policisë, nga 20 vetë", tha 81-vjeçari. Pas denoncimit të dy të moshuarve, policia e Vlorës ka nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të krimit.



Hetohet për mashtrim, Eduard Ndocaj: Sulm politik nga banditë me pushtet

DURRËS - Dy ditë më parë, policia ka ndaluar në portin e Durrësit ish-deputetin e Partisë Socialiste, Eduard Ndocaj, i njohur me nofkën "Kaubojsi". Mësohet se ndalimi i 42-vjeçarit është bërë me urdhër të policisë së Lezhës, pasi ai është kallëzuar nga një shtetas italian për mashtrim financiar. Sipas padisë së depozituar në policinë e Lezhës, shtetasi italian rezultoi të jetë partneri i Eduard Ndocajt në biznes. Burime nga policia bënë me dije se "shtetasi italian ka deklaruar se kur Ndocaj ka qenë deputet e ka takuar në Milano dhe i ka premtuar që do ta ndihmojë për të fituar tenderin për shtrimin e tubave të TAP. Për këtë gjë, sipas kallëzimit, Eduard Ndocaj ka kërkuar 50 mijë euro, të cilat italiani thotë që ia ka dhënë 2 herë nga 25 mijë euro. Por, duke qenë se nuk është bërë fare një tender i tillë, italiani ndihet i mashtruar dhe ka bërë kallëzim". Pas publikimit të lajmit për ndalimin dhe procedimin për veprën penale të mashtrimit, ka reaguar Ndocaj, i cili pohoi se është i lirë dhe se po udhëtoni me traget drejt Italisë. Gjithashtu, ish-deputeti deklaroi se ky është sulm i rëndomtë politik nga banditë me pushtet.

INTERVISTA



"NDËRTIMI NË BUTRINT"

Kumbaro prezanton projektin: Nuk shtohet asnjë centimetër

Fatmira Nikolli

Ky që shihet në fotografi është imazhi që do ketë godina e shërbimit në Parkun Kombëtar të Butrintit, prej ditësh i kthyer në temë debati mes aktorëve të ndryshëm të trashëgimisë kulturore, Forumit për Mbrojtjen e Trashëgimisë, opozitës dhe Ministrisë së Kulturës, e cila ka dhënë lejen për ndërhyrjen që po bëhet.

Në një intervistë të realizuar ditën e hënë (për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare"), ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro ka bërë publik edhe projektin e godinës së shumëpërfolur në Butrint, duke sqaruar dhe argumentuar pse sipas saj ky projekt është i domosdoshëm.

Gjatë ditës së martë, deputetja e Partisë Demokratike, Albana Vokshi në një deklaratë për mediat i ka kërkuar ministres Kumbaro sqarim për ndërhyrjen që do të bëhet në Butrint.

-Prej ditësh ka një debat të gjerë për një ndër parqet kryesore të trashëgimisë kulturore. Çfarë po ndërtohet në Butrint?

Nuk po ndërtohet asgjë e re. Një vit më parë kemi përgatitur një udhëzim të detajuar për krijimin e këndeve të shërbimit, që i quajmë këndet SAL (Suvenir, Art, Libra) në sitet e trashëgimisë kulturore. Në këto katër vite na ka ndodhur që pas zgjidhjes së problemeve të emergjencës, është shtuar numri i turistëve dhe në site ku turi zgjat dy orë si në Butrint, Gjirokastrë, Apoloni, turistët kanë nevojë edhe për një standard tjetër të shërbimeve, që nga një sanitare deri tek vendet e pushimit. Në këtë kontekst, ne në ruajtjet të trashëgimisë kulturore, kemi bërë një studim për të parë se cilat janë hapësirat ekzistuese brenda siteve, të cilat mund të ripërdoren, të rifunksionalizohen për të krijuar standard shërbimi. Ne kemi sot 170 mijë vizitorë në vit në Butrint. Kjo kërkon një menaxhim. Kemi ndërhyrë në Butrint me mbi 15 projekte, mirëmbajtje e restaurimi, si skena e amfiteatrit, etj. Vitin e kaluar bëmë ndërhyrje në rehabilitimin e pikave sanitare. Ajo që konstatojmë në një sit siç është Butrinti, ku itinerari zgjat dy orë, pika kulmore është muzeu, ku gjatë verës vizitorët ulen ku të gjejnë në bordura e në gurë dhe hapnin si në piknik, shisheet e ujtit e ushqime çka është normale për një rrugëtim dyorësh. Në këtë vend, para se të futesh te muzeu, ndodhet në të djathtë brenda hijes së pemëve një godinë e vogël, ekzistuese prej dekadash rreth 20 metra katrorë, që ka pasur në vite përdorime të ndryshme.

E përdorur nga arkeologët në vitet 1970 dhe në këto 10 vitet e fundit, një depo që përdoret ose nga arkeologët, por edhe një depo e pisët për sa u përket mbeturinave ose objekteve të dala jashtë përdorimit. Duke iu përgjigjur nevojës së vizitorëve për një shërbim, për një ujë, për një kafe, apo edhe për të blerë një material promovues të kontrolluar nga ministria, pasi deri sot kemi parë në Butrint lloj-lloj shitësish që shisnin deri akullore me kazan, deri shishe ujë me çmime të larta.

Në përgatitëm procedurat e nevojshme dhe bëmë një projekt për ripërdorimin e këtij objekti, pa i shtuar asnjë centimetër volum, pa i shtuar asnjë centimetër ndërtim dhe pa gërmuar nëntokën, si kusht i domosdoshëm përderisa jemi në zonë arkeologjike.

Puna aty po vazhdon, çdo gjë është e kontrolluar dhe bëhet fjalë për një shtesë, të një strehe krejtësisht reversible, dru edhe xham. Nuk ka asgjë që ngulet përfundimisht, është çdo gjë e lëvizshme.

-Sa afër është nga muri i shek.7-8 kjo godinë dhe ndërhyrja që po bëhet?

Godina në fjalë është aty ku ka qenë, as nuk e lëvizim, as nuk e afrojmë. Mbrapa godinës ndodhet muri, por i cili nuk preket fare dhe nuk ka fare lidhje me projektin. Puna përqendrohet në rehabilitim e kësaj godine, unë mund t'ju tregoj edhe fotografiat. Nuk preket absolutisht asnjë lloj guri tjetër dhe asnjë lloj muri tjetër dhe nuk bëhet asnjë ndërhyrje jashtë këtij objekti. E dyta, nuk bëhet asnjë lloj gërmimi, vendoset vetëm një shtesë me një rrjetë hekuri, për të vënë platformën mbi të cilën vendoset druri e xhami. Sa i takon procedurës, kjo nuk bëhet me buxhete publike, as me buxhetet e parkut, bëhet me



Në foto: Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro

Modeli i ri i trashëgimisë? Ministrja: Do paguhet qira dhe investimi i mbetet shtetit

investim të kompanisë që ka fituar procedurën, e cila jo vetëm bën gjithë investimin fizik, jo vetëm do të paguaje edhe qiranë, por i gjithë ky investim i mbetet parkut, edhe pas përfundimit të kontratës me subjektin përkatës, që është një shërbim që ofrohet me outsource, por krejtësisht i kontrolluar, i fiskalizuar dhe i formalizuar.

- A është ky modeli i ri i trashëgimisë? Një vendim i ngjashëm është dhënë edhe për kalanë e Tiranës, me struktura të lëvizshme, që ndërtohen pa u prekur nëntoka, ndërsa projektligji i ri i trashëgimisë e parashikon bashkëpunimin publik-privat?

Modeli në fjalë meqë është në një sit të administruar nga Ministria e Kulturës bëhet brenda hapësirës ligjore ekzistuese dhe brenda udhëzimit që ne kemi përgatitur. Ndërsa rasti i kalasë së Tiranës, nuk jemi në një sit pronë publike, por pronë private. Cëlsia e projektit ka ndjekur të njëjtat parime, duke qenë se jemi në zonë arkeologjike, ku nuk lejohet gërmimi. Aty bëhet fjalë në radhë të parë për strukturë të ngritur mbi tokë dhe me materiale krejtësisht të lëvizshme. Por jemi në një tjetër kontekst, ku bëhet fjalë për projekt privat, në një pronë private dhe ku ne japim miratimin për cilësinë e projektit, monitorojmë realizimin e tij, por nuk e menaxhojmë.

- Butrinti nuk ka një plan menaxhimi. Pse nuk është bërë akoma, çfarë ka çaluar?

Bërja e planit të menaxhimit për një sit aq të madh është një sfidë shumë e madhe dhe që bëhet mbasi ke stabilizuar parametrat kryesorë. Ka pasur një plan deri në 2005-ën dhe më pas është menaxhuar pa plan. Në vitin 2014 ne u përballëm

me probleme emergjence dhe në strategjinë tonë, i dhamë prioritet zgjidhjes së situatave të emergjencës, sepse ndërkohë nuk mund të frenonim fluksin e turistëve. Ndaj janë bërë 15 projekte dhe ndërhyrje, duke filluar që nga muri, i cili nëse ju kujtohet në fund të 2014-ës, ka pasur një rrezim, muri që tashmë është restauruar. Bëmë restaurime të rëndësishme dhe ndërhyrje në disa itinerare, bëmë mirëmbajtje në dy mozaikë, kemi pasur probleme brenda muzeut ekzistues me lagështinë dhe u bë një projekt ndërhyrjeje dhe po ashtu në pikat sanitare. Pra, siç e shikoni, gjërat vijnë në mënyrë progresive. Kapacitetet që u vunë në shërbim të problemeve të emergjencave ishin të nevojshme dhe pa zgjidhur ato, nuk mund t'i kushtojë energji e vëmendje kur ke probleme dite. Është bërë një draft menaxhimi, i cili rezultoi që kërkonte një angazhim më të madh të Ministrisë së Bujqësisë e Mjedisit dhe autoriteteve lokale. Një tjetër problem i madh ishte regjistrimi i pronave nëse ju kujtohet, nuk diheshin kufijtë e saktë dhe bëmë një studim topografik me ndihmën e Ministrisë së Mbrojtjes për të pasur kufijtë realë të Butrintit.

Plani i menaxhimit nuk bëhet vetëm nga ne, kjo kërkonte kuadrin ligjor më të saktë, ndaj kemi bërë projektligjin e ri që përcakton se si mund të gjenerohen të ardhura nga trashëgimia kulturore, pasi e kam thënë e do ta them: nuk është një natyrë e vdekur trashëgimia kulturore. Gjithë çkemi bërë e kemi bërë brenda kuadrin ligjor e këtë e them me përgjegjësi të plotë përkundër të gjitha përballjeve dhe manipulimeve që hidhen me një a foto.

- A mendoni se Shqipëria ka biznesmenë, që janë dashamirës të trashëgimisë?

Ne kemi bërë më parë rregullat. Kur nxorëm udhëzimin, na u hodhën në grykë dhe thanë do jepni kalatë me qira. Nuk më duket se kemi dhënë kala me qira. Ne krijuam kuadrin ligjor për t'u dhënë mundësinë që brenda rregullave të mund të kenë arsye për të investuar. Nuk mund ta lë këtë në duart e tyre, as pres të jenë dashnorë të trashëgimisë, por pres të investojnë nën kontrollin e rreptë të institucioneve që e kanë për detyrë këtë punë. Kemi pasur mungesa ligjore dhe kjo është lenë në vullnetin individuale. Unë risjell projektin e kalasë së Lezhës, që nuk kishte kuadrin ligjor që ne po ndërtojmë dhe parashikonte me firma e vula edhe të atyre që sot bërtasin një ndërhyrje në një nga kalatë me një pasuri historike arkeologjike. Arkeologët edhe sot janë të bllokuar nga disa vendime gjykatash. Lajmi i mirë që mund t'ju jap është se Gjykata e Lartë e ka kthyer vendimin për Lezhën dhe ne përgatitemi për të mbrojtur një kauzë për të cilën jemi shumë të bindur se kemi drejtë dhe që ai projekt nuk duhet zbatuar.



NDËRTIMI NË BUTRINT/ PD, THIRRJE QEVERISË: TË NDALEN PUNIMET, SHKELJE E PLOTË E LIGJIT

Deputetja e Partisë Demokratike, Albana Vokshi, në një deklaratë për mediat i ka kërkuar dje ministres Kumbaro sqarim për ndërhyrjen që do të bëhet në Butrint. Për ndërtimin në Butrint, PD i ka bërë thirrje qeverisë që të ndalohen punimet dhe të bëhet transparencë të plotë për këtë rast skandaloz. "Cili është destinacioni i ndërtimit dhe kush do ta menaxhojë atë? A është kjo një aferë tjetër korruptive? Edhe UNESCO u shpreh se nuk ishte informuar për këtë ndërtim. PD-ja i bën thirrje qeverisë të ndalojë çdo ndërtim deri në sqarimin e plotë të të gjitha dyshimeve. Prokuroria i bëjë hetime

të thelluara për këtë çështje. Ne deputetet i kemi kërkuar ministres Kumbaro dëgjese urgjente, që do të mbahet nesër në orën 17:00. Duhet bërë transparencë e plotë për këtë rast skandaloz", tha Vokshi. Të shtunën, ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro, e pyetur u shpreh se ka vënë në dijeni edhe UNESCO-n për ndërtimin. Ndërkaq, dir. Mechtild Rössler, drejtoreshë e Qendrës së Trashëgimisë Botërore në UNESCO, ka deklaruar se për atë që po ndodh në Butrint është njohur vetëm në fund të javës së kaluar dhe ka kërkuar informacion shtesë nga institucionet shtetërore shqiptare më 9 tetor 2017.

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikën e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së tetë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikën që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Trajtitimit të

Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkesën, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistrin janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe pro-

blematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodër, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfitojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të trullit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur.

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E TETË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

| Emri (Subjekti i shpronësuar) | Mbiemri (Subjekti i shpronësuar) | Emri (Subjekti Kërkuar) | Mbiemri (Subjekti Kërkuar) | Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë | Zona Kadastrale | NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP | Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2 | Sip. E Kompensuar M2 | Problematika |
|-------------------------------|----------------------------------|-------------------------|----------------------------|--|----------------------|-----------------------------|-------------------------------|----------------------|---|
| Mehmet | Mehaj | Mehmet | Mehaj | 3174m2 truall,are, pemishte | Puke / 3069 | 134 | rrezim te kerkeses | | Ka vert.pronesie Ka Genplan Vendimi nuk u ankimua |
| Isa | Kaduku | Asllan | Kaduku | 72m2 truall | Puke / 3069 | 115 | rrezim te kerkeses | | Ka VFJ Ka Harte |
| Bajram | Dizdari | Lirie | Demushi | Sip. E papercaktuar | Puke / 3069 | 116 | rrezim te kerkeses | | Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Beqir | Lagi(Hoxha) | Shyqyri | Laci | 20000m2 truall,are, livadh,kullote | Puke / 3069 | 117 | 7580 | 7580 | Ka VFJ Ka Genplan Vendimi nuk u ankimua |
| Halil | Dema | Halil | Dema | 1000m2 truall | Lajthize Puke / 2370 | 118 | 1000 | 1000 | Ka VFJ Ka planvendosje Vendimi nuk u ankimua |
| Ndue | Prenga | Ndue | Prenga | 5070m2 are 1375m2 kullote | Gjegjan / 1725 | 119 | 6445 | 6445 | Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Ndue | Gjoka | Ndue | Gjoka | 6692m2 livadh 4400m2 kullote | Gjegjan / 1725 | 120 | 11092 | 11009 | Ka vert.pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Martin | Gjeka | Martin | Gjeka | 5870m2 truall | Bushat / 1330 | 121 | 3850 | 3850 | Ka VFJ Ka planvendosje Vendimi nuk u ankimua |
| Frok | Zaja | Preng | Zaja | 23755m2 truall,pemishte,are,kullote | Gjegjan / 1725 | 122 | 3500 | 3500 | Ka vert.pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Pal | Prenga | Pal | Prenga | 6500m2 truall | Fushe Arrez / 1656 | 123 | 6500 | 6500 | Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Gjovalin | Bardhoku | Gjovalin | Bardhoku | 2550m2 truall | Fushe Arrez / 1656 | 124 | 2550 | 2500 | Ka VFJ Ka Genplan Vendimi nuk u ankimua |
| Marash | Marku(Vata) | Vate | Marku | | Porave / 3027 | 106 | 6457 | 6457 | Ka VFJ Ka Genplan Vendimi nuk u ankimua |
| Dede | Kasa | Sokol | Kasa | 123300m2 truall,are, kopesht | Porave / 3027 | 107 | 12300 | 10230 | Ka vert.pronesie Ka Genplan nuk u ankimua |
| Mark | Prekaj | Kole | Marashi | 13800m2 truall,are, kullote livadh | Porave / 3027 | 109 | 13800 | 10308 | Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Preke | Deda | Nike | Kasa | 300m2 truall 4800m2 are 650 m2 kopesht 150m2 duhanore 2800m2 kullote | Porave / 3027 | 110 | 6700 | 6700 | Ka VFJ Ka Genplan Vendimi nuk u ankimua |
| Gjon | Kasa | Ndue | Kasa | 11420m2 truall,are, pemishte, livadh | Porave / 3027 | 111 | 11420 | 10142 | Ka VFJ Ka Genplan Vendimi nuk u ankimua |
| Hamez | Zefi | Prele | Ndoci | 8830m2 truall,are, kopesht,kullote | Porave / 3027 | 112 | 8830 | 8830 | Ka VFJ Ka Genplan Vendimi nuk u ankimua |
| Hysen | Kasa | Mehill | Deda | 6480m2 truall,are, kopesht | Porave / 3027 | 113 | 6480 | 6480 | Ka vert.pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Kristina | Shestani | Kristina | Shestani | 130 m ² truall | Puke | 114 | rrezimin e kerkeses | | Ka VFJ Ka Genplan Vendimi nuk u ankimua |

(Vijon nesër)

Opinion i Ditës

Ambasadorët duhet të flasin edhe për Ramën dhe Bashën

Ferdinand Xhaferri

(Vijon nga faqja e parë)

... hezitimin të shkelnin në territoret e krimit. Skenat dëshmonin se përballja me krimin e organizuar nuk është çështje teknikash policie, por punë përzjerje qeverie. Policët u gjunjëzuan përballë një grupi kriminal jo se nuk dinin si të vepronin në emër të shtetit, por sepse dinin lidhjet e krimit me pushtetin.

Kohë më parë kemi parë policë arrogantë që fushin në burg ata të vobektë që nuk paguanin faturat e shtetit. Ama ditë më parë pamë policë të poshtëruar që nuk guxonin të futeshin në zonat e krimit të lidhur me pushtetin. Kjo e bën edhe më komike retorikën e Ramës për "bërjen e shtetit". Nga Elbasani, të gjithë pamë se në shtetin e Ramës ligji nuk është i barabart për të gjithë.

Kjo ngjarje dëshmoi gjithashtu, se e shkuara u ka mësuar policëve se kriminelët e lidhur me politikën janë jashtë juridiksionit të ligjit. Pra, në Elbasan nuk kapitulloi vetëm policia. Ajo që pamë na konfirmoi se ka kapitulluar edhe qeveria.

Incidenti në fjalë nxiti ambasadorët e Perëndimit të lëshojnë deklaratat bombë që shprehin një situatë emergjente në raport me krimin. Situata mund të jetë emergjente, por asgjë nuk ka ardhur në mënyrë emergjente. E thënë qartë, ky është thjesht produkti i krijuar nga kriminalizimi i Kuvendit dhe kanabizimit i vendit.

Mund të jetë vallë kryeministri i papërfshirë? Kur media dhe opozita paraqiste për ligjvënës të rilindës certifikata inkriminimi, Rama i përgjigjej me deklarata ironizimi. Kur opozita akuzonte se edhe avionët po përdoren për trafikimin, Rama përgjigjej se "mushkonjat i bëni avionë se doni të pengoni integritimin". Hezitimi me të cilin u larguan të inkriminuarit nga Kuvendi dhe vonesat për t'u marrë me kanabizimin e vendit na vërtetuan se këto ishin veprime të diktuar nga Perëndimi e jo nga reflektimi.

Në të vërtetë, kriminalizimi i Kuvendit edhe kanabizimi i vendit janë elementë të konkretizimit të filozofisë së Ramës për mar-



rjen dhe mbajtjen e pushtetit. Nga këtu merr kuptim domosdoshmëria që ambasadorët e Perëndimit të flasin edhe me Ramën edhe për Ramën për këtë problematikë madhore të Shqipërisë.

Është fakt i gjithëpranuar se vendi mbetet në rrezik domethënës sepse është kthyer në qendër të krimit të organizuar, duke përfshirë trafikun e drogës, armëve dhe prostitucionin. Teksa ambasadorët në tetor ngritën zërin sepse demokracia e brishtë shqiptare po rrezikohet nga krimi, opozita në shkurt ngriti çadrën sepse konkurrimi demokratik po vritej nga krimi. Opozita u detyrua të futej në zgjedhje edhe si pasojë

e angazhimit të ambasadorëve të Perëndimit.

Është vështirë të besohet se në një vend ku në tetor krimi është rrezik domethënës, në qershor të mbahen zgjedhje të lira dhe të ndershme. Shqetësimi madhor me zgjedhjet lidhet me faktin se rezultati nuk ishte çështje cilësie programi apo kandidati. Edhe në këto zgjedhje, Rama bëri atë që di të bëjë më mirë, të ndërtojë imazhin demokratik të tyre.

Zgjedhjet u shitën si të lira se nuk kemi më policë dhe të fortë që kërcënojnë të qendrat e votimit. E thënë më troç, zgjedhjet në Shqipëri nuk janë më punë kërbaci jashtë qendrave të votimit, por

thjesht punë kulaçi brenda shtëpive të banimit. Pra, përfshirja e parave të krimit ndikoi në mënyrë domethënëse që Basha të merrte një humbje edhe më të rëndë dhe Rama të merrte një fitore edhe më të plotë. Këtu nuk synojmë të lëmë në hije defektet e Bashës, por thjesht të theksojmë përmasën e pamerituar të humbjes së tij për shkak të përfshirjes së krimit.

Vendi ndodhet seriozisht i rrezikuar nga krimi, dhe është e qartë se sukcesi nuk mund të vijë pa angazhimin e Perëndimit. Gjithsesi, këto ditë po shohim presion në rritje ndaj qeverisë, duke dhënë shpresa se mund të ndryshohet qasja e saj në raport me krimin.

HOROSKOPI

DASHI

Hëna rrit optimizmin dhe aftësitë komunikuese. Vërtet do të jeni pak egocentrikë, por edhe të shkëlqyer dhe interesantë si kurrë më parë! E dini fatin tuaj, por do të arrihi edhe të përfiton nga rasti për të mësuar nga persona vërtet të veçantë.

DEMI

Plutoni jo shumë miqësor do t'ju kujtojë se duhet të ndërtoni marrëdhënie të karakterizuara nga ekuilibri i duhur midis rastësisë dhe vetëkontrollit. Vazhdoni të hani në mënyrë të shëndetshme, duke zgjedhur me saktësi ushqime të cilësisë së mirë.

BINJAKET

Me planetin e dashurisë që ju mbron, do të kërkonti mundësi dialogu dhe bashkëpunimi me personin e zemrës. Lidhja do të rezultojë më e forcuar. Falë Venusit që vazhdon t'ju mbrojt, nuk duhet të sforcoheni shumë për të qëndruar në formë.

GAFORJA

Mirëkuptimi i personave që ju qëndrojnë në krah do ta ketë të vështirë të çajë nervozizimin tuaj. Do të jetë e vështirë të ruani qetësinë ndaj atyre që vazhdojnë të bëjnë po të njëjtat propozime shumë e shumë herë.

LUANI

Me favorizimin e Jupiterit, nëse jeni në kërkim të një pune, dijeni se fati mund t'ju trokasë në derë. Mos rrini duarkryq. Falë Venusit mik që ju vëzhgon, mund të hapni një kapitull të ri në lidhjet tuaja dashurore.

VIrgJERESHA

Do të keni fërkime me një familjar që këmbëngul që gjithçka shikon mirë, ndërsa në realitet ka tensione të fshehura. Kush jeton në çift, duhet të bëjë kujdes që të mos ndërlikojë atë që është e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë.

PESHORJA

Venusi dhe Neptuni bashkëveprojnë me Hënë në favorin tuaj. Do të njihni persona, të cilët mund t'ju vërtetojnë menjëherë vlerën dhe singletitetin. Po kaloni një periudhë ndryshimesh në çdo fushë. Në pappirurat do t'ju bëjnë përsëri vizitë.

AKREPI

Ndonjë zënkë më shumë dhe klima dashurore do të ndikohet ndjeshëm. Do të jetë më mirë t'i kontrolloni reagimet tuaja të gjaknxehtësisë. Një mik, vetëm për të mohuar mbështetjen e premtuar, do të përpiqet t'ju fusë dyshime për zgjedhjen e bërë.

SHIGJETARI

Me Neptunin që ju mbron, mund të mbështeteni të miqësi dhe kontakte konstruktive. Jini të sigurt: jeta tuaj është duke evoluar në drejtime më interesante. Me Marsin armiqësor, kini kujdes nga gabimet në vlerësimin e shtjellave për të mos gabuar.

BRICJAPI

Do të kaloni disa zënka dhe do t'ia dilni të tejkaloni të gjitha pengesat që ju ndalojnë të merrni vesh me partnerin e dashur. Mos i lini pas dore çështjet private për të dëgjuar dhe për të ndihmuar një person që ju kërkon ndihmë.

UJORI

Në ndikimin e Uranit dhe Venusit priten, mbi të gjitha nëse jeni beqarë, perspektiva interesante risish në sektorin e dashurisë. Do të rrethoheni nga njerëz me të cilët ndihni mirë dhe do të mënjanoni ata që duan t'ju detyrojnë zgjedhjet edhe mendimet e tyre.

PESHQIT

Do t'ju duhet të përballeni me ndonjë të papritur, dhe nuk do të keni atë elasticitet që do të ishte i nevojshëm për t'u përballur me risi dhe për të riorganizuar programin. Kjo mënyrë e vazhdueshme për të pyetur të tjerët ndoshta fsheh paafësinë për të pranuar atë çka është e ndryshme nga ju.

BLUE TOOTH

THASHETHEME

MADE IN ALBANIA

te rejat nga jeta

Vipave

çm të shtunë falas me

Opinion *i* Ditës

Dr. Jorgji Kote

(Vijon nga faqja e parë)

...nga drejtuesit e lartë të diplomacisë sonë, gjatë këtyre ditëve të fundit ka pasur prononcime dhe intervista kritike edhe në median e huaj dhe nga vetë kryeministri Rama. BE-ja qortohet se po vonon padrejtësisht hapjen e negociatave me vendin tonë. Edhe pse zyrtarë të lartë evropianë kanë pohuar në disa raste dhe forume se ato mund të hapen vitin e ardhshëm, por gjithnjë me kushtoren: në qoftë se.

Në fakt, të paktën për vendin tonë, e kundërta është e vërtetë. Duke qenë dhe i përfshirë direkt në këto procese gjatë 20 viteve të fundit si diplomat në Tiranë, Berlin dhe në Bruksel deri muajt e fundit, them se, mjafton t'u hedhësh një sy kalimthi 25 viteve të dialogut tonë politik me BE-në dhe mund të bindesh lehtë për këtë fakt.

Kështu, menjëherë pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike BE-Shqipëri, në prill 1992 u nënshkrua Marrëveshja e parë e Bashkëpunimit me BE-në; ndërsa në vitin 1996 pothuajse ishte miratuar nga Komisioni Evropian Marrëveshja "sui generis" e Asociimit. Por, pas farsës zgjedhore të 26 majit 1996, krizës së piramidave të vitit 1997 dhe rebelimit të vitit 1998, gjithçka u desh të fillonte nga e para.

Më vonë, qëndrimi ynë moderues në rajon, dhe sidomos ndaj konfliktit të dhunshëm në Kosovë, u "shpërblye" nga BE-ja, veç të tjerash edhe me fillimin e procesit të stabilizim-asociimit. Ndonëse Samiti i Goteborgut në qershor 2001 vendosi hapjen e negociatave të shumëpritura, për të cilat diplomacia jonë kishte shpenzuar shumë kohë dhe energji, mazhoranca e asaj kohe filloi grindjet politike brenda vetes, duke e shtyrë në kohë integrimin në BE. Vetëm pas ardhjes së ish-Prezidentit të Komisionit Evropian dhe mikut të vendit tonë Romano Prodi në Tiranë, më 31 janar 2003, ky proces rifilloi me dy vjet vonesë. Megjithatë, nënshkrimi i marrëveshjes përkatëse u bë në vitin 2006, sepse korrupsioni galopant gjatë qeverisjes së atëherëshme e bënte të pamundur një gjë të tillë.

Në vitin 2009, edhe pse me sforcim, BE-ja pranoi kërkesën tonë për statusin kandidat. Kjo nuk u realizua sipas parashikimeve. Sërish, jo për faj të BE-së, por sepse ish-opozita e asaj kohe e bllokoi atë për tri vite rresht. Pak rëndësi kanë shpjegimet dhe justifikimet, sepse në fakt gjithnjë ka pasur një rrugë kompromisi, sidomos kur vjen fjala të integrimi evropian.

Më tej, konflikti mes mazhorancës dhe opozitës, kriza politike e vitit 2011, që kulmoi me vrasjen e katër qytetarëve të pafajshëm më 21 janar 2011, kërkuar sërish ndërmjetësimin e BE-së, duke shtyrë për më vonë statusin kandidat.

Me ardhjen e mazhorancës së re qeverisëse në shtator 2013, ishte radha e opozitës të asaj periudhe që të "hakmerrej", duke tentuar të vononte statusin. Më në fund,



në qershor 2014, pas shumë demarshve diplomatike u bë e mundur dhënia e statusit, por i pasqyruar me hapjen e negociatave. Këto të fundit u lanë për më vonë, pas plotësimit të pesë kushteve/prioriteteve të njohura.

Vërtet që po atë vit, Presidenti i ri i Komisionit Evropian, Juncker lëshoi deklaratën për ngrirjen e procesit të zgjerimit të mëtejshëm të BE-së gjatë këtyre pesë viteve. Por as ajo dhe as mangësitë në politikën e jashtme të BE-së nuk krijuan ndonjë pengesë praktike për vendet e rajonit dhe sidomos Shqipërinë.

Atëherë, ku qëndrojnë "gjynahet" e BE-së që këto negociata ende nuk janë hapur?

A kishte, bie fjala, mbështetje më të madhe gjatë katër viteve të fundit për gjithë klasën politike të Ballkanit dhe vendit tonë sesa Procesi i Berlinit me nismën e vetë Kancelare Merkel, me të "mëdhënjtë" e tjerë si Franca, Italia, Britania e Madhe dhe Austria dhe me mbështetjen e Komisionit Evropian?

A e ka fajin BE-ja që, me gjithë premtimet e shprehura nga pala jonë, akoma nuk ka filluar, në qytetin e vërtetë të fjalës, zbatimin e reformës së gjyqësorit dhe vetings, ndërkohë që kanabizimi i vendit mund të kthehet në pengesë tjetër serioze për çeljen e këtyre negoci-



Evropa asnjëherë nuk na është larguar, ajo na është ndodhur gjithnjë pranë, në ditë me diell dhe me shi; por ne nuk kemi ditur ose nuk kemi dashur ta kuptojmë, herë i jemi afruar dhe herë larguar, sipas interesave politike dhe zgjedhore të çastit.

atave? A e ka fajin BE-ja për krizën e stërzgatur ndërmjet dy partive kryesore, ngritjen e "Çadrës së Lirisë" dhe problemet e shkaktuara deri në prag të zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit? Kush pengoi që marrëveshja e 18 Majit të ishte arritur kohë më parë, kur Parlamenti Evropian u investua me dy protagonistë të njohur, nga e majta dhe e djathta, kurse Departamenti Amerikan i Shtetit me zyratari më të lartë të rajonit?

Ndaj, nuk ka kuptim t'i kërkosh hesap BE-së, e ca më keq ta "kërcënosh" atë se po nuk bëri

kështu dhe ashtu, do të bëhet "nami"! Aq më tepër, kur në shumë takime publike të niveleve të larta, bashkëbiseduesve tanë u është thënë troç: "Bëni detyrat e shulhtëpise! Kur të jeni gati, na thoni, dhe të nesërmen i çelim negociatat!" Më qartë nuk ka se ku të shkojë.

Nisur nga sa sipër, janë të panevojshme dhe madje të dëmshme kërkesat dhe deklaratimet me natyrë populiste dhe euroskeptike; ato vetëm sa shpenzojnë shumë kohë dhe energji të kanaleve tona diplomatike për të bërë sqarimet e ras-

tit në kancelaritë e 27 vendeve anëtare dhe institucioneve të BE-së. Gjithashtu do shmangur referimi të "alternativa të tjerë", sidomos kur vijmë nga zyrtarët tanë më të lartë dhe jo në forumet përkatëse. Lidhur me këto të fundit, edhe pse ne jemi për miqësi dhe bashkëpunim me të gjitha vendet e botës, asnjëra prej tyre nuk mund të zëvendësojë anëtarësimin në BE si alternativë të pakthyeshme dhe të panegociueshme.

Shkurt, Evropa asnjëherë nuk na është larguar, ajo na është ndodhur gjithnjë pranë, në ditë me diell dhe me shi; por ne nuk kemi ditur ose nuk kemi dashur ta kuptojmë, herë i jemi afruar dhe herë larguar, sipas interesave politike dhe zgjedhore të çastit.

Ndaj, tani që negociatat e anëtarësimit i kemi vërtet në prag të portës, të bëhemi vërtet gati duke mos përsëritur gabimet dhe vonesat e mëparshme, në mënyrë që të kompensojmë kohën e humbur me përgatitje serioze dhe të gjithanshme. Këtë presin nga ne BE-ja dhe aleatët tanë, këtë dëshiron dhe shumica dërmuese e popullit, që e shprehur dhe me votën e tij në zgjedhjet e datës 25 qershor 2017. Ndaj shefi i diplomacisë sonë, Ditmir Bushati, me të drejtë pohoi në një nga intervistat e tij të kohëve të fundit se "tashmë topi është në portën tonë".

Italiani i stolit kuqezi vlerëson 4 ndeshjet në drejtimin e tij dhe synon Europeanin

Panuçi: Na pret një e ardhme e ndritur

Trajneri: Me Xhakën u mbylla në dhomë për t'u sqaruar



Jeton Selimi

Nëse katër ndeshjet e fundit i shërbyen për të njohur skuadrën dhe për të eksperimentuar, pas mbylljes së kualifikueseve të "Botërorit 2018", Kristian Panuçi e ka një ide të qartë të asaj që do të bëjë Shqipëria. Trajneri premton një skuadër sulmuese në të ardhmen, që do të kërkojë të marrë rezultate nëpërmjet lojës. "Jam i kënaqur nga paraqitja e Kombëtares në dy ndeshjet e fundit. Luajtëm mirë ndaj Spanjës, skuadrës më të fortë në botë, ndërsa ndaj Italisë luajtëm si të barabartë, duke krijuar edhe 3-4 raste për shënim. Jam i kënaqur për idenë që po përcipim t'i japim skuadrës dhe që lojtarët po më ndjekin. Ideja është të mos bëjmë më hapa mbrapa, por përpara. Në dy miqësoret që do të zhvillojmë në nëntor do të provojmë skemat me dy sulmues. Kemi një vit kohë për të përgatitur "Europianin 2020". Jam i sigurt se kjo skuadër e ka cilësinë që të dalë nga zona e sigurisë dhe provojë të bëjë më tepër përpara. Duhet të dalim nga mbrojtja, por duke njohur edhe defektet tona".

Shqipëria sulmuese është një kërkesë edhe e vetë lojtarëve, që i kanë shfaqur dëshirën trajnerit për të guxuar. Duke nisur ndoshta nga Liga e Kombeve, aty ku kuqezi jetë do të përballesh me rivalin thuajse të njëjtit



nivel. "Jemi në fillim të një rrugëtimi, por duhet të krijojmë një ide dhe një bindje. Nuk do të kemi rastin të përballemi gjithmonë me Spanjën, ndërsa me ndeshje si këto të fundit besoj se mund të kishim fituar përballë ekipeve si Norvegjia apo Zvicra. Unë do të punoj për të luajtur futboll, pasi kjo skuadër i ka mundësitë. Nuk do të luajmë 3-5-2 apo të "parkojmë autobusin". Kemi një bazë shumë të mirë dhe do t'i luajmë ndeshjet tona me kurajë. Ideja është që të shkojmë të marrim pikë. Lojtarët më duken të bindur për atë që po bëjmë, skuadra di ta luajë futbollin që kërkoj. Absolutisht nuk duhet të heqim dorë nga cilësia për sasinë. Duhet të dalim nga 'guaska', sepse këtu njerëzit kanë dëshirë të

4

NDESHJE

Ka drejtuar Shqipërinë Kristian Panuçi, duke arritur një fitore ndaj Lihtenshteinit, një barazim ndaj FYROM-it dhe dy humbje ndaj Spanjës dhe Italisë.

jetojnë dhe këtë e shoh edhe te skuadra. Djemtë më thonë që duan të provojnë të luajnë në sulm dhe fakti që luajtëm si të barabartë me Italinë është një sinjal që mund të bëjmë më tepër".

Problemi kryesor i Kombëtares sipas Panuçit është intensiteti i lojës në disa liga ku aktivizohen lojtarët dhe kjo pasqyrohet edhe me rënien fizike të skuadrës në ndeshje. "I vetmi shqetësim lidhet me faktin që shumë lojtarë luajnë në Zvicër, Greqi apo Rusi. Intensiteti i

stërvitjeve apo i lojës në ato kampionate është shumë i ulët. Këtë problem kam. Nëse unë e ngre ritmin e stërvitjes, ata lojtarë lodhen. Do të doja të punoja tre muaj me ekipin që t'i bëj të ndejnë muskujt që dridhen. Me Italinë në minutën e 65-të lojtarët ranë fizikisht, megjithatë dua t'i falënderoj, sepse dhanë gjithçka në fushë. Ndoshta dikush u mërzit se i bëra të vraponin shumë, por të gjithë treguan shumë profesionalizëm. Jam i bindur se na pret një e

ardhme e ndritur".

Drejtuasi i stolit kuqezi foli edhe rreth ndryshimeve në ekip. Nga enigma Alban Ajeti, që duket se po pret Zvicrën, te dera e hapur për Manajn, afrimin e disa lojtarëve nga Kombëtares e moshave dhe nisja e turit të vëzhgimeve, me një listë prej 15 lojtarësh të shpërndarë nëpër Europë. "Do të nis udhëtimet për të gjetur lojtarë të rinj. Në ndeshjet e përfaqësueses së 19-vjeçarëve dhe tek ekipi Shpresa do të vëzhgoj dy-tre lojtarë, që më pas do t'i testojmë në ndeshjet miqësore. Alban Ajeti më jep ndjesinë që po pret Zvicrën. Gjithsesi, unë do shkoj ta takoj për të kuptuar çfarë dëshiron. Do të vëzhgoj edhe Manajn te Granada. Kam degëruar që është i vështirë, por kështu më thanë edhe për Xhakën. Megjithatë, kur e takova Taulantin ballë për ballë, ai më krijoi bindjen se nuk më tradhton dhe është i gatshëm të 'vdesë' në fushë. Edhe Manajn duhet ta njoh personalisht për të vendosur. Në sulm dhe në mesfushë kemi mjaft alternativë, por duhet të gjejmë lojtarë në mbrojtje. Agolli është 35 vjeç dhe në Europian do të jetë 37. Tani është shumë mirë, por duhet të mendojmë edhe në perspektivën e Europianit, ku aktualisht kemi dy të rinj si Balliu dhe Memolla. Do të ndjek Lilajn me Skënderbeun në Europa League, ndërsa kam edhe një listë me 10-15 lojtarë që do t'i shoh, të cilët luajnë në Gjermani, Greqi, Austri apo Sllovakia. Duhet të studiojmë gjithçka që mund të na ofrojë Europa. Ky ekip ka nevojë për kualitet".

E BUJSHME



Reali i Madridit vendos të largojë

Gareth Bejlin

Gareth Bejli, person "non grata" te Reali i Madridit. I transferuar me shumë bujë në radhët e klubit "Los Blancos", tashmë mesa duket sulmuesi uellsian konsiderohet si një element i panevojshëm për teknikun Zidane. Dëmtimet e shpeshta të 27-vjeçarit duket se janë dhe shkaqet se përse presidenti i Realit të Madridit së bashku me teknikun Zinedin Zidane po mendojnë të shesin lojtarin. Sipas asaj që raportojnë mediat britanike, klubi merengës ia ka ofruar Bale ekipit të Manchester Junajtid për shumën e 90 milionë eurove. Në fakt, teknikun i "Djajve të Kuq", Zhoze Murinjo tentoi t'ia shkëputte Realit, yllin e skuadrës gjatë merkatos verore, por një gjë e tillë nuk u realizua kurrë. Situa tashmë paraqitet ndryshe, këtë herë janë drejtuesit e klubit spanjoll, ata që dëshirojnë largimin uellsianit. Shuma është e përcaktuar 90 milionë euro, ndërkohë nga ana tjetër ish-futbollisti i Tottenhamit në disa raste është shprehur se ndihet komod tek merengës dhe as që e mendon aspak të largohet. Përtej dëshirës së Bale, gjasat janë që e ardhmja e tij të jetë larg Realit të Madridit dhe një gjë e tillë ndoshta mund të ndodhë që në merkaton dimërore.

DREJTORI I LACIOS

Tare: Panuçit i duhet dhënë kohë, Shqipëria ekip me identitet

Ish-bombieri i Kombëtares, Igli Tare, i cili aktualisht mban postin e drejtorit sportiv te Lacio, ishte djepi i prezencës së "Loro Borici" për të ndjekur ndeshjen Shqipëri-Itali, që përfundoi me fitoren 0-1 të miqve. Në një prononcim për "Top Channel" në fundin e ndeshjes, Tare ka deklaruar se i duhet dhënë kohë trajnerit Panuçi dhe nuk duhet ta venë atë në presion. 44-vjeçari vlerëson lojën e kuqezinjve, për të e rëndësishme është që Shqipëria është një skuadër me identitet. "I duhet dhënë kohë trajnerit se ne e kemi zakon tashmë t'i vëmë nën presion. Ai është duke bërë një punë të mirë me ekipin, por sigurisht ka nevojë për më shumë kohë. Çdo periudhë ka pasur mënyrën e vet të lojës, nuk mund të gjykoj njeri, e rëndësishme është që në këto momente Shqipëria është një skuadër me identitet", u shpreh drejtori sportiv i Lacios, Igli Tare.



TURNËU I 19-VJEÇARËVE

Turpërohet Shqipëria, Norvegjia luan tenis me kuqezinjët

Shqipëria U-19 i ka bërë mbylljen në të turpshme të mundshme kualifikueseve të Kampionatit Europian. Kuqezinjët e drejtuar nga Erjon Bogdani u mposhtën në "Selman Stërmasi" përballë Norvegjisë me rezultatin e thellë 1-7. Burba kaloi Shqipërinë në avantazh në minutën e 12-të, por rezultati u përmbyes shumë shpejt dhe pjesa e parë përfundoi me shifrat 1-4 me golat e shënuar nga Haland në minutat 18 dhe 28, Marković në minutën e 32-të dhe Vetlesen në minutën e 44-të. Në pjesën e dytë, Oestigard shënoi golin e pestë në minutën e 66, Marković shënoi në minutën e 72-të dhe Pedersen shënoi në minutën e 78. Në minutën e 87 kuqezinjët mbetën edhe me 10 lojtarë pas kartonit të kuq të Myrteza-it. Pas 3 ndeshjesh, Shqipëria U-19 nuk ka marrë asnjë pikë, duke u renditur në vendin e fundit në Grupin 12.




KUALIFIKOVI POLONINË NË BOTËTOR

Levandovski mbyll studimet "bachelor" në Universitetin e Varshavës

Sulmuesi i Kombëtares polake, pasi ndihmoi venëtin e tij të arrijë kualifikimin direkt për në "Rusi 2018", ka mbyllur edhe studimet "bachelor", në degën e Edukimit Fizik, në Universitetin e Sporteve të Varshavës. Një ditë pas përfundimit të fushatës eliminatore, ku ish-lojtari që shënoi edhe 16 gola, 29-vjeçari ishte i pranishëm në ceremoninë e diplomimit, teksa u vlerësua edhe nga profesorët e tij për rezultate të shkëlqyera në studimet e tij. Levandovski mbyll studimet pas një periudhe 10-vjeçare në këtë degë dhe tashmë do jetë i përqendruar plotësisht tek kriza që po kalon Bajerni dhe tek Polonia e tij.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Pupi regjisor.
- 5. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
- 11. Turner aktore.
- 12. Fillojnë festat.
- 13. Skuadër greke.
- 14. Falen pa fe.
- 15. U shkrua nga Gorkij.
- 18. Një sferë për... model.
- 19. Janë bisha.
- 22. Parashtesë për dy.
- 23. Demoni që persekutonte Sarën.
- 24. Stacion i famshëm orbital.
- 25. Mendes regjisor.
- 27. Një rreth i ngushtë miqësor
- 29. Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
- 30. Këndohen në opera.
- 32. Eshhtë lajm i vjetër.
- 34. Sharif aktor.
- 35. Martin i Norma Rae.
- 36. Mund të jenë filmi.

- 38. Një jepet për hartim.
- 39. Ami i Maupassant.
- 41. Fundi i Turandot.
- 42. Halli këngëtare.
- 45. Neill i Jurassic park.
- 47. Pineda e Garcia Lorca-s.
- 48. Giorgio stilist

VERTIKAL

- 1. Morisette këngëtare.
- 2. Kilmer aktor.
- 3. Hechë aktore.
- 4. Fillojnë tatëpjetën
- 5. Eshhtë diapozitiv shumë i ndjeshëm.
- 6. Mbyllin spitalë.
- 7. Në krye të masave.
- 8. Bëjnë shirit me shi.
- 9. Qe vajza e Tantalit.
- 10. Janë më shumë se dëshira
- 12. Ishte dekret i sulltanit.

- 15. Qe mbreti i urtë i Pilos.
- 16. Quinn aktor.
- 17. Gasol i NBA.
- 20. Fillojnë garën.
- 21. Një pjesë e reformave.
- 26. Eshhtë si biskotë.
- 28. Mund të jetë karmelitan.
- 29. Sjellin shi.
- 30. Bel i Maupassant.
- 31. Dreq pa ekstreme.
- 33. Gjysma e bimëve.
- 34. Mbyllin një motor.
- 36. Eshhtë bitum.
- 37. Fara këngëtare.
- 38. Hanks aktor
- 39. Stiller aktor.
- 40. Morrison rockstar.
- 42. Fillojnë masat.
- 43. Në krye të tabelës.
- 44. Derisa janë në fund.
- 46. Fund filmi.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- 1. Film i hitchcock.
- 6. Fillojnë premierën.
- 7. Janë legjendat.
- 11. Kush ka... ka zët.
- 12. Thurman aktore.
- 15. Një pjesë e testamentit
- 16. Një pjesë e studimeve.
- 18. Kështu është situata e tensionuar.
- 21. Telefonë në kartvizitë.
- 22. Eshhtë ngasje.
- 24. Në krye të autoriteteve.
- 25. Mbyllin mbledhjen.
- 26. Pason abetaren.
- 28. Nisin nga kreu.
- 29. Fillojnë aafirmim.
- 30. Cocker këngëtar.
- 31. Bartok kompozitor.
- 33. Triac që qe tenis.
- 35. Oxa këngëtare.


- 36. Kalimi në ekstreme.
- 37. U shkrua nga Zola.
- 39. Fise pa fe.
- 40. Eshhtë mballomë.
- 41. I mungon apatikut.
- 43. Një pjesë e medaljeve.
- 44. Një këngëtar lirik.
- 46. Pak torturuese.
- 48. Ka privilegjin e jetës.
- 51. I famshmi Pacino.
- 52. Nasi shkrimtar.
- 53. Janë temperaturat më të ulëta.
- 54. Me pit në box.

VERTIKAL


- 1. Janë enigmatikë.
- 30. Cocker këngëtar.
- 3. Rrjedh në klepsidër.
- 33. Triac që qe tenis.
- 5. Fillojnë rubrikën.
- 6. Ishte babai i Prokinit dhe Filomelës.
- 8. Vitet pa kufij.
- 9. Mbyllin kanate.
- 10. U shit për një pjatë thjerza.
- 13. ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
- 14. Moore aktore.
- 17. Rocca aktore.
- 19. Janë përmasa.
- 20. Fund dhjetori.
- 23. Mbyllin krahum.
- 26. Fillojnë kalimin.
- 27. Duhet ruajtur.
- 32. Ishte Europa komuniste.
- 34. Agjenci Kombëtare Lokale
- 38. Berg kompozitor.
- 40. Të parat në Amsterdam.
- 42. Elsa këngëtare.
- 45. Memoria në computer
- 47. Me të nxjerrin trashë.
- 49. Në mes të dhomës.
- 50. Ekstreme kateti.
- 52. Kufijtë e lujtes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | | 1 | | 9 | | 4 | | 2 |
| | 7 | | | | | | 3 | |
| | 6 | | 4 | | 7 | | 8 | |
| 2 | | | | 1 | | | | 3 |
| | | | 9 | | 6 | | | |
| 3 | | | 7 | | | | | 8 |
| | 2 | | 1 | 5 | | 9 | | |
| | 3 | | | | | | 1 | |
| 8 | | 5 | | 6 | | 7 | | 4 |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 5 | 2 | 1 | 7 | 3 | 8 | 4 | 9 |
| 9 | 7 | 8 | 5 | 6 | 4 | 2 | 1 | 3 |
| 4 | 3 | 1 | 8 | 9 | 2 | 7 | 6 | 5 |
| 5 | 9 | 6 | 3 | 1 | 8 | 4 | 2 | 7 |
| 1 | 4 | 3 | 9 | 2 | 7 | 6 | 5 | 8 |
| 8 | 2 | 7 | 4 | 5 | 6 | 3 | 9 | 1 |
| 3 | 1 | 4 | 2 | 8 | 5 | 9 | 7 | 6 |
| 2 | 6 | 9 | 7 | 3 | 1 | 5 | 8 | 4 |
| 7 | 8 | 5 | 6 | 4 | 9 | 1 | 3 | 2 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Jemi ajo që mendojmë. Ajo që jemi është produkt i mendjes sonë. Çdo fjalë ose vepër që lind nga ndonjë mendim i turbullt ndiqet nga vuajtje, ashtu si rota e karrocës që ndjek këmbët e demit.
- Mos mbivlerëso atë që ke marrë dhe mos lakmo tjetër: Ai që lakmon tjetër nuk do arrijë paqen e mendjes.



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|---|----|----|----|----|----|----|----|
| 5 | 1 | 11 | | 18 | 3 | 10 | | 18 | 2 | 1 | 15 | 20 |
| 3 | 2 | 6 | 5 | 3 | 2 | 1 | 5 | | 1 | 13 | 1 | |
| 21 | | 4 | 3 | 5 | 6 | 2 | 1 | 5 | | 5 | 10 | 5 |
| 1 | | 6 | 10 | 1 | 2 | 8 | 11 | 6 | 4 | 1 | 5 | |
| 2 | 13 | 7 | | 2 | 1 | 5 | 1 | | 1 | 2 | 8 | 11 |
| | | 19 | 1 | 7 | 3 | 5 | 6 | | 15 | 14 | | 10 |
| 13 | 3 | 5 | 2 | | 5 | 6 | 11 | 1 | | 1 | 5 | T |
| 5 | 2 | | | 21 | | 19 | 6 | 2 | 1 | 5 | | E |
| 1 | 5 | 7 | | 6 | 2 | 8 | 5 | 10 | 8 | 6 | | |
| 16 | 8 | 7 | 8 | 17 | 6 | 5 | | 1 | 6 | | 21 | 6 |
| 6 | | | 15 | 8 | 5 | 1 | 5 | | | 18 | 3 | 10 |
| 4 | 3 | 18 | 8 | 7 | 6 | | 18 | 6 | 4 | 6 | 7 | 1 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| K | A | B | D | M | T | E | T | K | | | |
| U | E | N | E | I | D | A | P | A | R | A | |
| P | U | K | S | S | N | K | I | A | T | | |
| A | R | S | H | T | A | T | A | N | I | K | E |
| T | O | P | E | R | A | T | O | R | E | | |
| M | I | N | E | R | A | L | E | T | I | K | |
| B | O | E | R | B | I | T | B | T | U | | |
| P | A | R | T | I | I | A | S | I | N | I | R |
| U | R | I | M | A | S | I | S | I | S | | |
| L | I | M | E | N | A | O | R | I | | | |
| A | M | E | R | I | K | A | T | U | B | I | M |
| T | E | R | R | E | N | E | T | K | A | D | I |

Ehënie të mençura

- Miku më i madh i së vërtetës është koha, më i madh i armik i saj është paragjykimi, ndërsa shoqëruesia e përhershme është përlësia.
- Fol vetëm atëherë, kur ajo çfarë ke për të thënë është më e bukur se heshtja...
- Në jetën tuaj do të jenë disa njerëz, që në një moment të caktuar do të bëhen shokët tuaj, dhe do të jenë disa shokë që në një moment të caktuar do të jenë thjesht shokë...
- Gabimi i atij që punon me dëshirë dhe ëndje është më i mirë se të qëlluarit e atij që punon pa dashje.

Koltoni

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

